



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

Kulti i numrave në kulturën shqiptare

Kandidati:
Armina Shabani

Mentor:
Prof. dr. Mustafa Ibrahim

Tetovë,
2018

Përmbajtje

Mirënjohje.....	5
HYRJE	6
1. Lënda e hulumtimit.....	8
2. Qëllimet e hulumtimit.....	8
3. Hipotezat.....	9
4. Metodologjia e hulumtimit	9
5.Rëndësia e punimit.....	10
Kultura shqiptare.....	12
Përralla	13
Balada	15
Anekdotat.....	17
Fabula.....	19
Legjenda (gojëdhëna).....	20
Lirika popullore shqiptare.....	21
1. Histori e numrave.....	22
2.Numra kulturi në lashtësi	24
1. Numri tre dhe karakteristikat e tij	26
1.1 Shembuj nga numri tre në përralla:.....	27
1.2 Shembuj nga numri tre në balada :	31
1.3 Shembuj nga numri tre në lirikat shqiptare :.....	35
2 Kuptimi i numrit tre në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore).....	41
3 Klasifikimi i leksemave për numrin tre	47
4 Numri tridhjetë.....	48
5 Kuptimi i numrit tridhjetë në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore)	50
6 Klasifikimi i leksemave për numrin tredhjetë.....	51
7 Numri treqind.....	52
8 Kuptimi i numrit treqind në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore)	54
9.Klasifikimi i leksemave për numrin treqind	55
1. Numri shtatë dhe karakteristikat e tij.....	56
1.1 Shembuj nga numri shtatë në përralla:.....	57
1.2 Shembuj nga numri shtatë në balada :	59

1.3 Shembuj nga numri shtatë në lirikat shqiptare.....	60
2.Kuptimi i numrit shtatë në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore)	63
3.Klasifikimi i leksemave për numrin shtatë	66
1. Numri nëntë dhe karakteristikat e tij.....	67
1.1 Shembuj nga numri nëntë	68
2.Kuptimi i numrit nëntë në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore).....	74
3.Klasifikimi i leksemave për numrin nëntë	76
1. Numri dymbëdhjetë dhe karakteristikat e tij.....	77
1.1 Shembuj nga numri dymbëdhjetë	78
1.2 Shembuj nga numri dymbëdhjetë në balada :	80
1.3 Shembuj nga numri dymbëdhjetë në lirikat shqiptare:	81
2.Kuptimi i numrit dymbëdhjetë në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore) ...	83
3.Klasifikimi i leksemave për numrin dymbëdhjetë	84
1. Numri dyzet dhe karakteristikat e tij.....	85
1.1 Shembuj nga numri dyzet	85
2.Kuptimi i numrit dyzet në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore)	87
3.Klasifikimi i leksemave për numrin dyzet	89
PËRFUNDIMI	90
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	92
PËRMBLEDHJE	94
РЕЗИМЕ	95
SUMMARY	96
Fjalor	97

Mirënjohje

Mirënjohje për të gjithë ata që më ndihmuan ta përfundoj këtë rrugëtim që e fillova, realizimin e këtij punimi e arrita me mund por me shumë dëshirë duke u bërë pjesë e bashkëpunimit edhe shumë njerëz tjerë, i falemderoj edhe njëherë nga zemra.

Mirënjohje dhe falënderime për mentorin e tezës së masterit, prof.dr.Mustafa Ibrahim, për mbështetjen profesionale dhe akademike që më ka dhënë gjatë gjithë procesit të punimit të masterit, për përkushtimin, këshillat dhe nxitjen të cilat kanë ndikuar në realizimin dhe pasqyrimin më të mirë të tezës së masterit, por edhe në formimin tim profesional kërkimore -shkencore.

Mirënjohje të veçantë kam për profesorët e mi të cilët më ndihmuan gjatë studimeve: prof.dr.Vebi Bexheti, prof.dr.Zeqir Kadriu, prof.dr. Hamit Xhaferi, Prof.dr. Luljeta Adili – Çeliku, prof. Meral Shehabi, prof. dr. Jehona Rushidi. U jam gjithashtu shumë mirënjohëse gjatë gjithë këtyre viteveqë me punën e njohuritë e tyre, kanë bërë të mundur që mua të më trefishohet dashuria me të cilën e nisa këtë rrugë drejt dijes.

Fjalët e fundit të miat për falenderim shkojnë drejtë familjes sime të shtrenjtë, duke e falënderuar për mbështetjen , durimin dhe mirëkuptimin e treguar gjatë gjithë kësaj kohe.

I rikujtoj disa herë fjalët e profesorëve të mi ku thoni : “Asnjëherë mos mendoni se rruga e mundimshme por e bukur drejtë dijes, përfundon në një stad të jetës, ajo rrugë nuk mbaron asnjëherë, mos e konsideroni atë ditë si përfundimi i diçkaje por konsideroje si një fillim të ri, gjithë jeta jonë është një rrugëtim pa fund drejtë dijes”.

HYRJE

Qasja e sistemit ndaj semantikës nënkupton zbulimin e lidhjeve dhe varësive ndërmjet njësive gjuhësore në planin e përmbajtjes, si dhe përzgjedhjen e grupit përkatës leksik, i cili do të ishte i organizuar semantikisht dhe i përshtatshëm për analiza. Një nga këto grupe përbëhet nga emra për numra, të cilët me kuptimin e tyre nominativ, simbolizmin, rolin dhe rëndësinë për njeriun, krijojnë të gjitha kushtet për një analizë komplekse të kuptimit.

Studimi i emrit për numrat në folklor ofron mundësinë për të përdorur kontekstin historik dhe kulturor për të zbuluar shkaqet e ndryshimit të kuptimit nominativ të emrit për numrat dhe për të parë të gjitha mundësitë e luhatjes shprehëse të potencialit të tyre semantik.

Në shekullin XIX, folkloristika lind si një shkencë për çështjen me të cilën merret folklori; se si shkenca e strukturës përbëhet nga zakonet popullore dhe besimet, bestytnitë dhe legjendat, poezi dhe tregime të shkurtra, format e artit dhe lëvizjet - me një fjalë, çdo gjë që përfshin artin folklorik të fjalëve, dizajnin, lëvizje, muzikë etj. Rezulton e lidhur direkt me shkencën e gjuhës, folklori merr vendin e saj në momentin kur ajo u shfaq epokë e re krahasuese materiale, gjuhë klasike e epikave indiane, krahasimet e tij me gjuhët e tjera indo-evropiane dhe perceptimin e ngjashmërisë së tyre. Një bollëk i materialit të mbledhur ishte shkaktuar nga analiza folklorike paralele.

Folklori është pjesë e literaturës, më saktë, literatura vjen nga folklori. Folklori është një para-histori e letërsisë. E gjithë literatura e njerëzve në një fazë të caktuar mund dhe duhet të studiohet në bazë të folklorit. Folklori fillimisht mund të jetë pjesë përbërëse e ritualit. Me krijimin ose zhdukjen e ritualit, folklori veçohet prej saj dhe fillon të jetojë një jetë të pavarur. Nga ana tjetër, tema e etnografisë janë popujt, etnosi, historia e tyre etnike, mënyra e jetës, linjat karakteristike të kulturës së këtyre popujve, origjina e tyre (etnogjeneza). Etnografia merret me studimin e formave më të hershme të jetës materiale dhe organizimit shoqëror të popullit. Kjo është arsyeja pse folkloristika historike, e cila studion shfaqjen e fenomeneve, mbështetet në etnografi për fazën e tyre të parë.

Ky studim bën fazën e parë të studimit të hollësishëm historik.

Prandaj, midis folklorit dhe etnografisë, ka një çelës të fortë. Nga etnografia, folklori nuk mund të studiohet. Sidoqoftë, përralla, poezia rituale, betejat, se si një zhanër nuk mund të shpjegohet pa përdorimin e të dhënave etnografike. Dhe jo vetëm zhanret, por shumë motive

gjithashtu gjejnë shpjegimin e tyre në konceptet dhe praktikat fetare-magjike në nivele të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Këtu është çelësi dhe etnolinguistika që ka për qëllim për të treguar se si gjuha në forma të ndryshme të ekzistencës së saj dhe historinë e saj kanë ndikuar në historinë e kombit, shtetin dhe llojin e një etnosi, disa grupe sociale në shoqëri, si për metodat gjuhësore që mund të ndihmojnë në zgjidhjen e detyrave të ndryshme të etnografisë dhe sociologjisë. Në etnolinguistik detyrat përfshijnë përdorimin e analizës së gjuhës, marrëdhënie me gjuhën e situatave të ndryshme gjuhësore, në klasa të ndryshme sociale dhe grupmoshave. Për etnolinguistikën njësi të ndërtesës nuk është vetëm gjuha, por edhe njeriu, individi, veprimet e tij dhe veprimet e tij në lidhje me gjuhën dhe përmes gjuhës. Kërkimi për burimin e folklorit në mitin origjinal u bë metoda bazë e shumë folkloristëve, veçanërisht atyre që i përkasin të ashtuquajturës shkollë mitologjike, e cila ka udhëhequr në Evropë që nga fillimi i shekullit XIX deri në fund të dekadës së parë të shek. XX (F. I. Buslajev, Orest Miler, A. A. Kotljarevski, etj.).

Variantet leksiko-semantike të formuara përmes llojeve të ndryshme të transmetimit të kuptimit, krijojnë një pasqyrë të veçantë konceptuale, origjinale për folklorin, kryesisht për përrallat, epokat, besimet, ritualet e popullit shqiptar, por me universale të përcaktuara objektivisht, të cilat përbëjnë bazën për konfrontim.

Të dhënat për mitologjinë, etimologjinë, etnografinë dhe historinë e gjuhës u përdorën për të përcaktuar interpretimet themelore funksionale-kontekstuale të kuptimeve në punë.

Shqiptarët kanë një kulturë të zhvilluar por disa qasje janë të pa studiara nëse marrim mitologjinë shqiptare kanë një pasuri të madhe mitologjike por ende të pa studiuar të tërën, tashmë ne i dim si figura më të përmendura në mitologji zanat, orët e shumë figura të tjera që janë pjesë gati se e çdo rrëfimi, por nuk mund ta lëmë anash edhe përdorimin e numrave të kultit që përmenden vazhdimisht bashkë edhe me këto figura por edhe pjesë të tjera mitologjike, por që shumë pak mos themi që farre nuk janë studiuar në përralla, këngë, balada etj.

Vazhdimisht numrat që janë përmendur në përralla, balada, këngë janë të përmendura njëkohësisht me figura mitologjike që na lë të mendojmë më shumë rreth pasurisë së mitologjisë shqiptare.

Për të sqaruar më mirë e më në bërthamë kultin e disa numrave ndër shqiptarë, duhet të hyjmë në parahistorinë e në funksionet e tyre simbolike, të mbinatyrëshme, në kohë shumë të lashta, e në faza të ndryshme të zhvillimit të njerëzimit. Numrat me zanafillë më të lashtë e ata më të hershmit në sistemet e numërimit kanë funksione kulturi në shumë raste.

1. Lënda e hulumtimit

Numrat që kanë funksione simbolike, përdorimi i tyre në disa rite magjike, pra numra të kësaj natyre janë quajtur: numra të shenjtë, numra magjikë, numra fati, numra fatkeqësie, numra simbolikë. Këto numra për të cilët bëjmë fjalë këtu vetëm në raste të veçanta marrin cilësi të mbinatyrëshme si: në rite të ndryshme, në përcaktime religjioze, në simbole të mbarësisë e të ruajtjes nga e keqja, në veprime magjike që kanë karakter të fshehtë, misterioz. Disa herë këta numra në simbolikën e tyre tepër të fshehtë në kohët e vona nuk na paraqiten si numra magjik, fatsjellës, por si numra më të mirë, më të dashur, më të pëlqyeshëm, por që në rrënjën e tyre të herëshme paraqesin dukuri mitike. Secili popull ka mitet, besimet e tyre pikërisht edhe populli shqiptar është i tillë. Kam zgjedhur vetëm anën e kultit të numrave besimet rreth këtyre numrave që lidhet me traditat dhe zakonet e popullit shqiptar.

Me historinë e numrave e me kultin e disa prej tyre janë marrë jo pak studiuës: matematicientë, eksplorues të vendeve të disa bashkësive primitive që mbijetojnë si të tilla deri në shek. XX, mitolog e studiuës të historisë së religjioneve me rrënjë në lashtësi.

Për të sqaruar më mirë e më në bërthamë kultin e disa numrave ndër Shqiptarë, duhet të hyjmë në parahistorinë e në funksionet e tyre simbolike, të mbinatyrëshme, në kohë shumë të lashta, e në faza të ndryshme të zhvillimit të njerëzimit. Numrat me zanafillë më të lashtë e ata më të hershmit në sistemet e numërimit kanë funksione kulturi në shumë raste.

2. Qëllimet e hulumtimit

Kjo tezë magjistrature ka për qëllim përmes një hulumtimi t'u përgjigjet shumë pyetjeve siç janë: kuptimet e këtyre numrave, besimet e popullit shqiptar në disa numra të caktuar, ku i hasim këto besime etj.

Disa nga synimet që e kanë paraprirë këtë punim janë:

- Çfarë simbolike kanë këto numra
- Secili vend i ka besimet e ndryshme rreth numrave
- Cilat janë traditat dhe zakonet që lidhen pikërisht me disa numra
- Shumë pak studiuës gati se fare nuk janë marrë me këtë analizë që është e nevojshme për kulturën shqiptare

- Si pikë e rëndësishme e këtij punimi është se lidhet edhe me etnolinguistikën edhe folklorin shqiptar.
- Do të hulumtohen këngë, përalla, anekdota, fabula, vepra, poezi etj.
- Të definohen dhe përkufizohen nocionet bazë të lidhura me temën dhe lëminë e hulumtimit.
- Të theksohet rëndësia dhe roli i temës në këtë tezë magjistrature në shoqërinë bashkëkohore.

3. Hipotezat

Megjithatë këto vlerësime në një mënyrë janë të parëndësishëm sepse mund të mjeçgullojnë problemet e vërteta të traditës, kulturës shqiptare, anadaj në këtë studim ne do të paraqesim këto hipoteza:

- Mitologjia paraqet një dukuri të ndërlikuar, ajo duhet të studiohet në veçanti si kultura, tradita etj.
- Nëse në këtë drejtim definojmë kultin e numrave parashtrahet pyetja a përdoren edhe sot a ka besime rreth atyre numrave edhe në ditet e sotme?
- Këto numra përdoren edhe tek arbreshët, arvanitasit, arbërorët.
- Vallë a ndryshojnë besimet rreth këtyre numrave nga vendi?
- Sa janë ruajtur këto anë mitologjike shqiptare edhe në brezat e reja dhe a besojnë?
- Pikërisht më shumë numrat e kultit hasen nëpër këngët kreshnike, poezi, përalla etj.

Sqarimi i kësaj lëmie do të paraqitet përmes formës teorike apo edhe të hulumtimit ku do të rezultojë mundësia e analizimit më të thellë të temës.

4. Metodologjia e hulumtimit

Fazat e kërkimit

Faza përgatitore

1. Studimi i literaturës.
2. Studim i folklorit shqiptar

3. Formulimi i platformës studimore “Numrat e kultit në kulturën shqiptare”

Faza e mbledhjes të të dhënave

1. Studim i këngëve, përallave, anekdotave, legjendave
2. Studim i prozave, baladave popullore
3. Materialet leksiko-frazeologjike e folklorike në periodikë të kohës.
4. Materiale të tjera nga fusha e mitologjisë, folklorit, etnokulturës.

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

1. Përqasja me studime të mëparshme
2. Analiza e veçorive folklorike dhe shqyrtimi duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë.
3. Shqyrtime të thelluara dhe mbështetëse për kultin e numrave
4. Përgjithësime dhe përfundime.

Metodologjia e kërkimit

Duke u nisur nga qëllimi i punimit, metodologjia e kërkimit u mbështet në shqyrtimin e folklorit shqiptar:

Së pari mbledhja e materialit konkretisht të lidhur me temën, pikërisht folklori, mitologjia, kulti, numrat çdo lidhje ndërmjet kultit të numrave me folklorin shqiptar.

Së dyti çdo shembull meret nga vepra të folklorit shqiptar si dhe në balada shqiptare, përalla shqiptare, anekdota, këngë kreshnike etj.

5. Rëndësia e punimit

Një temë si ky punim nuk është studiuar më parë, tradita dhe kultura shqiptare është mjaftë e zgjeruar por kërkon një analizë më të thellë.

Në punimin në vazhdim kam shfaqur kultin e disa numrave në popullin tonë që edhe sot e kësaj dite përdoren në rite, zakone të ndryshme po nuk e kanë atë rëndësi të madhe si në kohët e më parshme, njëjtë kemi edhe numra kulti në popujt e ballkanit si në Kroaci, Bosnje, Sërbi etj.

Besime popullore si tek numri tre, shtatë dhe nëntë dalin shpesh në besimet popullore shqiptare dhe po shpesh lidhen me fuqi magjike. Numri tre mund të haset në: tri të mirat ose

fatet, që vijnë te foshnja tri ditë pasi ka lindur; tre qirinjtë që ndizen në të kremten e Shënkollit; tre kungujt me ujë në dasmën korçare; ngritja dhe ulja tri herë e arkivolit para varrimit në Malësinë e Madhe; të tretat pas një vdekjeje në Tiranë e Gjirokastrë; tri tufat e flokëve që merren gjatë ceremonisë së qethjes së flokëve për herë të parë; tri vrimat në gurë që përdoren për betime të shenjta; si edhe në përrallat popullore shqiptare: tre vëllezërit, tri mollët, E Bukura e Dheut me dy motrat e saj, etj.

Numri shtatë del në: shtatë gjuhët e kuçedrës ose lubisë; shtatë varret e Sari Salltëkut; shtatë ditët dhe netët, kur një baba rri shtrirë në krevat për kuvade; si dhe Sancti Septenarii (s.v.), dmth. të quajturit shenjtorë shtatë-numrash të ortodoksizmit të Ballkanit jugor.

Numri nëntë del, për shembull, në: periudha prej nëntë vjetësh e nëntë ditësh në legjendën e Aga Ymerit; nëntë bijt në legjendën e Doruntinës dhe nëntë vjetët që Gjergj Elez Alia që i kalon në shtratin e vdekjes. Numra magjike të tjerë janë numrat 12, 40.

Ky punim magjistrature dhe hulumtimi i tij mund të jenë pjesë e librit ose i skriptës, e cila nuk do të jetë e përkushtuar vetëm për studentët apo intelektualët, por edhe për individë tjerë të cilët janë para së gjithash në kontakt të drejtpërdrejt me ndryshime. Prej këtu del imperativi i tij përfundimtar- të shërbejë si material informues rreth kulturës dhe traditave shqiptare, folklorit shqiptar etj.

Kultura shqiptare

Kultura është tërësia e arritjeve të një populli dhe të gjithë njerëzimit në fushën e prodhimit dhe në zhvillimin shoqëror e mendor. Kultura, si qëndrim i vecantë i njeriut ndaj mjedisit rrethues, dallohet nga karakteri krijues dhe simbolika. Ajo është tipar dallues vetëm i njeriut të të gjitha epokave, qysh nga fillimet e procesit të hominizimit. "...njeriu fillon të bëhet i tillë, në dallim nga kafshët e tjera, pikërisht sepse koncepton botën në mënyrë simbolike" Kultura mund të ndahet në disa mënyra, sipas kohës, vendit dhe sipas grupimeve të njerëzimit.

Kudo që të shkosh në Shqipëri çdo vend i ka karakteristikat e veta, secili është krenar për vendin e tij, secili mban gjurmë të veçanta nga vendi ku kanë lindur dhe rritur.

Flamuri shqiptar me shqiponjën dykrerëshe e zezë në sfondin e kuq është simboli më sublim i shprehjes së identitetit të shqiptarëve kudo që jetojnë. Në të gjitha shtetet e botës presidenti betohet mbi Bibël apo Kuran, në Shqipëri betim i tillë bëhet para flamurit.

Gjuha - Gjuha zyrtare në Shqipëri është gjuha shqipe, ajo e ka origjinën nga ilirishta dhe është një degë e veçantë në familjen e gjuhëve indo-evropiane.

Feja – Në Shqipëri shumica e popullsisë është muslimane rreth 80%, por ka edhe nga ata të fesë katolike që jetojnë kryesisht në jug rreth 10% dhe ortodokse në veri 10%, veçori e feve në Shqipëri është toleranca e secilës fe për të ushtruar besimin e vet.

Arti – Shqipëria është e njohur edhe për një traditë tepër të pasur të artizanatit me vlera të çmuara, të krijuara prej shekujsh.

Duke qenë një nga pjesët më të lashta të trashigimisë tonë kulturore, mitologjia popullore paraqet interes të shumëanshëm shkencor, historik, etnologjik, estetik, lingvistik dhe kulturor. Mitologjia është grrumbull përfytyrimesh të gabuara mbi botën, të krijuara nga njerëzit e paditur, mitologjia është poezia e lashtë, janë figura të trilluara, imagjinare të bukura poetike, mitologjia është përrallë e pavërtetë, rreth këtyre të thënave më poshtë kemi mjaftë shembuj në kulturën shqiptare.

Në kulturën shqiptare kemi kultin e disa numrave që edhe sot e kësaj dite përdoren në rite, zakone të ndryshme po nuk e kanë atë rëndësi të madhe si në kohët e më parshme.

Përralla

Përrallat janë krijime mjaft të vjetra, janë lloji më i gjatë dhe më i njohur i prozës gojore. Ajo me fabulën e jashtëzakonshme dhe me specifikat stilore ka depërtuar në të gjitha poret e jetesës, në kasollat primitive malore, në shtëpitë e pasura qytetare, në udhëkryqet tregtare, në oborret e vetmuara e të paaritshme fisnike, por edhe në shkolla e biblioteka dhe kudo ka zgjuar interes të përhershëm si te dëgjuesit e lexuesit, ashtu edhe te studiuesit. Struktura e saj është më komplekse se e rrëfimeve të tjera të prozës gojore. Element kryesor i saj është e jashtëzakonshmja, fantastikja, mitikja.

Studiuesit e letërsisë gojore e sidomos përfaqësuesit e studimeve tipologjike krahasimtare konstatojnë se struktura e brendshme e përrallës, modeli i saj, lidhet ngushtë me pasqyrimin e objektit të saj: me botën dhe realitetin që pasqyrohet në të. Ajo është bartur nëpër shekuj pikërisht sipas formës së saj karakteristike. Ndryshimet që paraqiten në modelet e strukturimit të saj mundësojnë të përcillet koncepti i evolutës së vetëdijësimit të krijuesit dhe të pranuesit të përrallës.

Përralla është kultivuar në të gjitha periudhat historike dhe në strukturën e saj rrëfimore secila ka vënë vulën e vet. Në përmbajtjen e saj hasen elemente të jetës fisnore, të mesjetës e të krishterimit të hershëm e të vonë. Në jetën e saj kanë marrë pjesë të gjitha marrëdhëniet ekonomike e politike të popujve. Kështu, aty zbulojmë gjurmë të lufrave kryqëtare, të luftës kundër sundimit osman e kundër sundimeve të tjera. (Neziri, 2010:159)

Disa studiues mendojnë që janë mbetje të miteve të lashta; ato kanë një strukturë universale, çka është veti e përbashkët për përrallat e çdo populli, idetë që ato përçojnë lidhen me dëshirat dhe ëndrrat e njerzimit për një jetë shumë më të bukur, më të pastër e më me imagjinatë sesa ajo që iu ofron realiteti, është shumë e veshtirë të kerkohet origjina dhe vendlindja e përrallës, pasi variante të ngjashme duken te popuj të ndryshëm.

Përralla i thjeshtëson situatat e veprimet. Personazhët janë të portretizuar, detajet janë eliminuar. Ata më tepër janë të jashtëzakonshëm. Personazhët nuk janë ambivalentë – nuk janë në të njëjtën kohë edhe të mirë edhe të këqinj. Marrësin e pushton karakteri i fortë i tyre, personaliteti i atij që e kryen veprimin. Ai nuk identifikohet me protagonistin e përrallës për mirësinë dhe cilësinë e tij, por pse pozita e protagonistit të përrallës e përvetëson. Veprimi i përrallës nuk kufizohet në kohë e në hapësirë, as nuk bën përshkrime të plota të figurave. Ajo si formë poetike njihet sistemin e shkallëzimit, ku plekset një mënyrë e veçantë e shprehshmërisë poetike, e vërejtjeve, përvojave, mendimeve. (Neziri, 2010:160)

Përralla si gjini letrare i paraprin zhvillimit të prozës e të letërsisë së shkruar. Fakti se ajo është rrëfim që materializohet nëpërmjet gjuhës dëshmon se nëpërmjet rrëfimit e formëson realitetin artistik si model, si projektion, si fikcion. Përralla përshkruan një botë të pakufishme, ku personazhet veprojnë në kohë e në hapësirë të papërcaktuar, kalojnë pengesa të tilla që në realitet në asnjë mënyrë nuk mund të realizohen. Kjo dëshmon se realiteti i përrallës i kundërvihet realitetit jetësor. Ky realitet manifestohet si kërkesë për veprim të pakufishëm, ku mund të realizohet çdo dëshirë. (Neziri, 2010:160)

Përrallat ishin janë dhe do të jenë si një ndër krijimet më të vjetëra popullore, që populli me aftësitë e veta i krijoi.

Balada

Balada është një nga llojet më të përhapura të letërsisë popullore shqiptare. Ajo, ndryshe nga disa lloje të poezisë legjendare që i kanë zonat e veçanta të shtrirjes së tyre, është përhapur në të gjitha viset shqiptare, si brenda hapësirës ballkanike, ashtu edhe në diasporën shqiptare jashtë kësaj hapësire. Pra balada është këngë që ka shtrirje mbarëkombëtare, por i ruan veçanësitë e zonave të caktuara në bazë të faktorëve etnogeografikë që kanë ndikuar në krijimin e saj.

Me interes të veçantë është sidomos balada e arbëreshëve të Italisë, në të cilën janë ruajtur edhe shumë tipare karakteristike të këngës popullore shqiptare të periudhës së mesjetës, më saktësisht të asaj periudhe që shënon fazën e veçantë të lulëzimit të kulturës popullore para pushtimit osman ose të epokës së lavdishme të historisë shqiptare të luftërave të popullit tonë nën udhëheqjen e Skendërbeut, të cilën romantikët arbëreshë e kanë quajtur me të drejtë Moti i Madh. (Fetiu,2000:9).

Balada është formë letrare me ndjenja të fuqishme. Në ndërtimin e strukturës së saj poetike shpesh përdoren dialogje, të cilët janë në harmoni me emocionet dhe synimet e heroit. Me ballafaqimin e dy palë ndjenjave pasqyrohen problemet e kundërthënieve midis heronjve.

Në momentin e konfrontimit të tyre realizohet pjesa më intenzive e thurjes baladeske: këtu vërehet qenësia e fisnikërisë dhe të tragjizmit, të emocioneve që mbërthejnë heronjtë.

Ndërtimi i veprimit bëhet me anë të dialogut: hyrja është e natyrshme, fillohet me ngjarje, narracioni nuk ndërtohet me përshkrime të gjata: koha kalohet shumë shpejt: metamorfoza është e shpeshtë dhe përdoret për ta fuqizuar dashurinë (burrë-grua dhe motër-vëlla) dhe idenë e vazhdimësisë së saj; në gjendjen shpirtërore të personazhit, si qenie e gjallë, marrin pjesë elementet e natyrës. (Neziri, 2010:61)

Tipi më i vjetër i baladave popullore shqiptare, sado që në të vërtetë trajton probleme reale jetësore, përshkohet nga një varg situatash, fenomenesh e rrethanash fantastike, në të cilat funksioni i veprimit të lëndës mitologjike si formë e përvetësimit artistik, luan rol të dorës së parë.

Veprimet e mrekullueshme të heronjëve të baladave, siç janë ngritja e të vdekurit nga varri, ringjallja, ëndërrat paralajmëruese, transfigurimet në qenie të tjera të botës shtazore ose bimore, pastaj komunikimi me qenie të tjera mitologjike siç janë : zanat, kuçedrat, drangonjtë e të tjerë, komunikim me trupa qiellorë, si Hëna e Dielli dhe një varg situatash të tjera fantastike. (Fetiu,2000:25)

Baladat ndryshe nga këngët e eposit heroik, duke trajtuar elemente të jetës zakonore, kanë fituar karakter ritual. Kështu disa balada këndohen në ditë të shënuara ngjarjesh familjare a në të kremte të tjera popullore: *Konstandini i Vogëlith dhe Ago Imeri* këndohen zakonisht nëpër dasma; *balada e besës*, në Jug – ditëve të festave të pranverës. Ky karakter ritual zakonor tregon se disa tema baladash sjellin elemente të një botëkuptimi të hershëm pagan, që ka ushtruar një ndikim të fuqishëm në fantazinë popullore.(Neziri, 2010:62)

Gjatë shekujve balada është ndryshuar jo vetëm midis popujve të ndryshëm, por edhe brenda një populli.

Anekdotat

Anekdotat është një tregim i cekët, shpesh i nxehtë ose qesharak në të cilin zbardhet veçoria karakteristike e një personi të njohur, një dukuri të njohur, një tip të njerëzve. Zakonisht, anekdotat neutrale përfundojnë me pikë kthese të befasishme të tregimit, apo edhe me thënien e një personi nga i cili nuk do të pritej. Anekdotat shpesh përshtellohet me aforizmat, barcoletat dhe epigramet.

Anekdotat janë thënie të mençura, tregime të shkurtëra shpotitëse e satirike, përmes së cilave interpretohen dukurit e ndryshme shoqërore, ndodhi të personaliteteve të njohura etj. Japin një pasqyrim metaforik por edhe alegorik të realitetit tonë me të cilin përballemi çdo ditë. Këto tregime të zgjuara, që ishin karakteristik komunikimi tek shumë popuj ballkanas në të kaluarën, e në veçanti në disa treva shqiptare (ku akoma janë prezente, edhe pse të zbehura nga evoluimi kohor), arrijnë që përmes mesazheve të japin aspekte nga jeta, në dukje të vogla por me vlerë përgjithësuese, duke i vënë në lojë klasat sunduese, pushtuesit, tradhtarët, qeveritarët, personalitetet publike etj, por duke mos lënë pa atakuar as problemet e ndjeshme sociale, ekonomike, politike etj.

Shkathtësia e këtij komunikimi të drejtpërdrejt me dëgjuesin dhe roli si mburojë a si shtizë ndaj kundërshtarit, i kanë siguruar anekdotave, por edhe aforizmave, fjalëve të urta etj. një vend të rëndësishëm në thesarin e kulturës shqiptare, por edhe një jetë të gjallë e aktive, me një humor të hollë e satirë therëse, edhe sot e kësaj dite.

Anekdotat si formë e veçantë e shprehjes artistike të prozës gojore paraqet një tërësi më vete të interesimit studimor. Ajo është e popullarizuar shumë dhe gjithmonë zgjon interesimin e gjeniut popullor dhe të mendjes njerëzore, si për nga forma e realizimit artistik të strukturës, po ashtu edhe për nga tematika, në të cilën përpunohen anë të ndryshme të jetës njerëzore. Ajo përcjell jetën e njeriut prej nismës së paraqitjes së dukurive, me të cilat ai u ballafaqua në vazhdimësinë e jetës së vet, përball zhvillimit mendor e historik-tekologjik. Me to njeriu shprehu disponimin e vet ndaj paraqitjes së formave të ndryshme të zhvillimit shoqëror dhe mohimin e këtyre dukurive, që lidhen me jetën familjare, fafëfisnore, fqinjësinë, miqësinë, armiqtësinë etj.

Anekdotat paraqet botën mendore dhe intelektuale të njeriut të thjeshtë, të njeriut të përvuajtur në luftë të vazhdueshme me dukuri të ndryshme jetësore. (Neziri 2010:170).

Anekdotat shqiptare paraqitën interes për shumë mbledhës, të cilët bënë publikimin e tyre në përmbledhje të veçanta, ose në kuadër të përmbledhjeve të ndryshme të këngëve ose të prozës gojore.

Midis botuesve të anekdotave rëndësi kanë botimet e Thimi Mitkos, në *Bleta shqiptare* (1878), të J. U Jarnikut (1883), G. Majerit (1896), *Tregime popullore* bl. I (Prishtinë 1963) i Anton Çettës, *Folklor shqiptar I – Proza popullore*, vëllimi V (Tiranë 1972) etj.

Anekdotat është krijim poetik, i cili me një epizodë rrëfen vetëm një ngjasë, ku me mprehtësi dhe ironi ose satirë rrëfëhet ngjasa jo me qëllim që të mësohet, por të përqeshet e nënçmohen veset dhe veprimet e njerëzve në jetën e përditshme. (Neziri 2010: 171)

Fabula

Përrallëza ose fabula është krijim letrar në të cilin personazhë kryesor janë kafshët dhe bimët dhe nëpërmjet roleve që luajnë simbolizojnë tipare njerëzore, pra, me gojën e kafshëve e të bimëve flasin njerëzit. Janë të afërta me anekdotat. Termi fabulë origjinën e ka në antikë. Në to përshkruhen karakteret, veset, veprat, jeta, morali dhe ideali njerëzor. Këtu e jashtëzakonshmja është fryt i një mjeti të caktuar artistik, i personifikimit.

Në përrallëzë kafshëve e bimëve u jepen cilësi apo të meta të njerëzve, sipas “ngjashmërisë”. Ndaj edhe efekti i tyre është moralizues.

Lindja e këtij lloji letrar të prozës gojore ndërlidhet me kohën e egërsisë, kur njeriu jetonte nga prodhimet e frutave e nga gjahu dhe kur ishte në kontakt të përhershëm me botën bimore e shtazore dhe me botën natyrore të zgjidhjes së problemeve jetësore, kështu, psh: në përrallëzat e shumë popujve do të dalë luani simbol i monarkut despot; ujku, leopardi, ariu e ndonjë kafshë tjetër përfaqësues i krerëve të etshëm për grabitje e të paepshëm për pushtet; dhelpra përfaqëson oborrtarin lajkatar, servil e dinak etj.

Në përrallëza kafshët nuk kanë asgjë mitike dhe të jashtëzakonshme, gjithçka është e natyrshme, mbizotëron shprehja e dialogut, mungon përshkrimi i ambientit dhe i vendit të zhvillimit të veprimit. (Neziri 2010:148).

Legjenda (gojëdhëna)

Legjenda, ose gojëdhëna është tekst rrëfyes nga goja e popullit i cili u kushtohet personave ose dukurive që ndodhin apo kanë ndodhur dhe që këta persona apo dukuri kanë lënë gjurmë në jetën e një shoqërie njerëzore. Në këto tregime ndodhitë e gjithave personazheve apo aftësitë e personave prezantohen si fuqi mbinatyrore mirëpo lidhen me ndonjë të vërtetë ndërsa rëndësia e tyre apo efekti i tyre mundohen të prezantohen në tregim si fuqi mbinatyrore e çka tregon se si njerëzit e kanë ndjerë efektin e ati personi apo asaj dukurie. Dallimi i legjendës apo gojëdhënës nga llojet e tregimeve tjera është se legjendës nuk i dihet koha dhe vendi i zhvillimit të ngjarjes, ose njëri nga këto elemente.

Po thuaj se ndër të gjithë popujt e botës kanë legjenda e tyre. Po ashtu edhe shqiptarët kanë legjendat e tyre, disa në nivele më të ulta e disa kanë arritur që të jenë edhe legjenda gjithë popullore. Si legjenda gjithë popullore ndër shqiptarë ndër të tjera janë edhe *Gjergj Elez Alia*, *Rozafa*, *Besa e Konstandinit*, *Ymer Aga Ulqini etj.*

Në legjendë mbizotrojnë elemente mbinatyrore, që nuk i hasim në përralla, lënda është konkrete me të dhëna historike e gjeografike, individë të dalluar, shenjtorë, kafshë të jashtëzakonshme, emra të qyteteve, të vendbanimeve. (Neziri 2010: 152)

Lirika popullore shqiptare

Fjala lirikë e ka origjinën nga greqishtja - lyra që do të thotë një instrument i lashtë muzikor. Në këtë gjini shquhet dhe mbizotëron natyra lirike; këtu bëjnë pjesë të gjitha llojet e poezisë së lashtë, siç janë : himni, oda, ditirambi, epigrami, epitafi, idila, elegjia etj.

Në gjininë lirike futen ato krijime,në të cilat autori nuk rrëfen ngjarjet,por shpreh ndjenjat dhe mendimet e tij.Kryesisht këto janë poezi të shkurtra.Rrëfimi është në vetën e parë.

Në veprat e gjinisë liriko – epike, jeta pasqyrohet nga një anë në tregimin në vargje të sjelljeve dhe ndjenjave të njerëzve, të ngjarjeve në të cilat ata marrin pjesë nga ana tjetër në shfaqjen e e emocioneve të vetë poetit, emocione që atij i ngjallen nga tablotë e jetës nga sjellja e peronazheve të tregimit të tij poetik.

1. Histori e numrave

Numrat që kanë funksione simbolike, përdorimi i tyre në disa rite magjike, pra numra të kësaj natyre janë quajtur: numra të shenjtë, numra magjikë, numra fati, numra fatkeqësie, numra simbolikë. Këto numra për të cilët bëjmë fjalë këtu vetëm në raste të veçanta marrin cilësi të mbinatyrëshme si: në rite të ndryshme, në përcaktime religjioze, në simbole të mbarësisë e të ruajtjes nga e keqja, në veprime magjike që kanë karakter të fshehtë, misterioz. Disa herë këta numra në simbolikën e tyre tepër të fshehtë në kohët e vona nuk na paraqiten si numra magjik, fatsjellës, por si numra më të mirë, më të dashur, më të pëlqyeshëm, por që në rrënjën e tyre të herëshme paraqesin dukuri mitike.

Me historinë e numrave e me kultin e disa prej tyre janë marrë jo pak studiuës: matematicientë, eksplorues të vendeve të disa bashkësive primitive që mbijetojnë si të tilla deri në shek. XX, mitolog e studiuës të historisë së religjioneve me rrënjë në lashtësi.

Për të sqaruar më mirë e më në bërthamë kultin e disa numrave ndër shqiptarë, duhet të hyjmë në parahistorinë e në funksionet e tyre simbolike, të mbinatyrëshme, në kohë shumë të lashta, e në faza të ndryshme të zhvillimit të njerëzimit. Numrat me zanafillë më të lashtë e ata më të hershmit në sistemet e numërimit kanë funksione kulturi në shumë raste.

Në fillim për konceptin bazë të numrit janë përdorur gjymtyrë e element të ndryshëm të trupit të njeriut. Ka pasur madje deri në fillim të shek. XX bashkësi primitive në Afrikë, në Brazil që dinin të numronin vetëm deri në dy deri në tre ose deri në katër.

Njëshi konsiderohet si numri më i lashtë, dyshi si fillim është përdorur si sinonim i dy duarve dy këmbëve, treshi në fillim është konceptuar dhe përdorur si mbleshje e njëshit dhe dyshit, treshi në disa popuj primitiv është përdorur si numër fatsjellës, magjik. Pra nga treshi janë formuar edhe shumëfisha të treshit si psh: gjashta ishte dy tresha, nënta ishte tre tresha, dymbëdhjeta ishte katër gishtat e dorës, me një bazë me nga tre falangje.

Tërë gishtat e këmbëve dhe të duarve bënin numrin 20 që në popuj të ndryshëm ka një kult të veçantë. Ka qenë tepër i dallueshëm te qytetërimi Maja në Meksikë, te Keltët, te Babilonasit ku ka pasur dhe një kult të veçantë për këtë numër, si fatsjellës. Si emërtim si sistem numërimi te italianët ky numër ruhet “*venti*”, te francezët “*vee*”, te shqiptarët “*njëzet*” “*dyzet*” e ndër Arbërorë të Greqisë dhe Arbëreshët e Italisë “*trezet*”, “*katërzet*”.

Numri shtatë ka zanafillë astrologjike, nga shtatë ndriçuesit kryesorë të qiellit që njiheshin në kohën e lashtë: Dielli, Hëna, Marsi, Afërdita, Mërkuri, Jupiteri, Saturni si astrologji prej Babilonisë e prej këtej erdhën në brigjet e Mesdheut, të Europës, këtej e kanë origjinën dhe ditët e javës.

Numri tre pothuajse në tërë popujt është numër magjik e lidhet me dukuri shenjtërie,po në disa vende është edhe numër fatkeqësi prurëse pra i magjisë së zezë.Në përgjithësi edhe trembëdhjeta është numër magjik simbol i së keqes, por ka edhe vende ku ky numër është edhe fatprurës.Në shumicën e vendeve njerëzit gjatë ndonjë udhëtimi në tren, autobus, aeroplan kursesi nuk e duan ulsen me numër 13 nga frika se mund të ju ndodh ndonjë fatkeqësi.Banorët e lashtë të Amerikës Qëndrore dhe Jugore besonin se numri 13 është i shenjtë dhe se përdorimi i tij sjell lumturi.(Tirta 2004:358-361)

2. Numra kulti në lashtësi

Edhe në ditët e sotme disa numra kanë attribute kulti, është e kuptueshme se këto koncepte për të mbinatyrshtmen në numra, i kanë rrënjët në lashtësi e më tej, në parahistori. Në kohë të hershme në Mesjetë e më tej ka pasur më shumë numra kulti ndërsa ditët e sotme më pak. Sot në vende të ndryshme të botës numra kulti janë këta: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 9, 10, 11, 12, 13, 28, 40, 240, 228, 100, 1000. Ndër Shqiptarë me sa kemi mundur të hetojmë deri tani me dëshmi të besueshme janë pesë numra: 3, 7, 9, 12, 40.

Nganjëherë edhe shumëfishi a nënfishi i një numër të kultit hynë në këtë radhë qoftë ndër Shqiptarë, qoftë dhe ndër popuj të ndryshëm të botës. Kështu nga 12 morën ato veti të përmendura dhe 6 e 24. Ndër popuj të tjerë nga shtatë bëhet numër kulti dhe 49 (7x7) ose 63 (7x9). Ndër popuj të tjerë nga treshi ka dalë si i tillë dhe 33. Ndër shqiptarë nga treshi përdoret në simbole kultike dhe 30 ose 300.

Numrat kultikë të lashtësisë janë shqyrtuar nga shumë mendje të shkencës e këta pra si numra janë të lidhur me perënditë, me dukuri të mistershme, të mbinatyrshtme, po dhe përgjithësisht me aspekte të veçanta të etnokulturës së popujve.

Numrat me attribute kulti kanë ardhur te ne tepër zbehtë e në raste të rralla dalin qartë si numra magjikë, të shejtë, me simbolikë religjioze, si numra fati.

1. **Njëshi** si baza fillestare e numërimit ka pasur vlera të veçanta në kuptimin filozofik e mistik, këtë e vërejmë edhe te Pitagora, te Njëshi i Platonit dhe i neoplatonistëve.
2. **Dyshi** si fillim është përdorur në kohë të lashta e te popujt primitivë të Kohës së Re ka qenë numër i shenjtë dhe është përdorur si sinonim i dy duarve dy këmbëve.
3. Numri **tre** pothuajse në tërë popujt është numër magjik e lidhet me dukuri shenjtërie, po në disa vende është edhe numër fatkeqësi prurëse pra i magjisë së zezë. Në krishterim treshi mbizotëron në kode e në rite: Trinia e shenjtë është tepër e veçantë për vlerat e saj të shquara në gjithësi, me treshin janë të lidhura mundimet e Krishtit dhe po tre ditë qëndroi në varr: Një seri lutjesh kishtare si formula klishe, përsëriten gjithmonë tri herë, edhe në Kuran në disa sure përmendet treshi.
4. **Shtata** është numër astrologjik krejt i veçantë i shenjtë për Babilonasit *7 ditët e javës, 7 shpirtërat e keqinj, 7 mure të botës së ferrit*.
5. **Dhjeta** është i shenjtë për aq sa përmban shumën 3+7 është bazë e sistemit dhjetorë është vlersuar si numër i prerë dhe i përkryer: *10 janë Urdhërimet e Zotit, 10 janë vuajtjet e Egjiptit*.

6. **Dymbëdhjeta** është numër me natyrë kulturi: *12 portat e Parajsës, 12 muajt e vitit, 12 orët e ditës dhe të natës.*
7. **Dyzeta** është numër simbolik që shpreh periudhat pritëse të parashikimit e të pendesës: *40 janë ditët e përmytjes së madhe, 40 ditë gjatë të cilave Ebrejt udhëtuan në shkretëtirë, 40 ditë Moisiu kaloi në Sinai.*
8. **Shtatëdhjeta** kulturi i saj vjen nga të qenët shumëfish i shtatës: *70 popujt e tabelës etnografike të Gjenezës, 70 pleqtë e Izraelit, 70 pasuesit e Krishtit, 70 vite e përmytjes së madhe.*(Tirta 2004:362-365)

Kur numrat e kultit kanë të bëjnë me dukuri të caktuara të besimeve të ndryshme, simbolika e tyre e mbinatyrshme, mistike, është krejtë e qartë, siç ngjet me shembujt e rreshtuar më sipër.

1. Numri tre dhe karakteristikat e tij

Numër më i rëndësishëm në kulturën shqiptare është numri tre, si numër kulti që është ruajtur nga e kaluara por që zë një vend të rëndësishëm edhe në kohën e re. Ky numër si dhe të tjerat na njihen si numra të mirë, numra më të dashur, më të përdorshëm, si numra më të pëlqyeshëm e më fisnik, ndërsa si fatsjellës a fatkeqësiprurës dalin më tërthorazi.

Kemi shpeshherë raste kur në një tekst, përralla, poezi, këngë që përnjëherë përdoren dy numra magjik që kanë lidhje me anën mitologjike të popullit shqiptar.

Në qarkun ballkanin në Antikitët e deri në Mesjetën, i vërejmë ndër shqiptar dhe në Kohën e Re e të sotme numra të kultit që na dëshmojnë, nëse ske një lidhje me të kaluarën është e vështirë të saktësohet karakteri mistik të disa numrave që erdhën si të tillë deri në Kohën e Re. Numrat e kultit na shfaqen si numra më të pëlqyeshëm e më fisnikë, më të përdorur, më të dashur ndërsa si fatsjellës a fatkeqësiprurës dalin më tërthorazi.

Nganjëherë në shprehje simbolike na paraqiten dhe dy a tre numra kulti bashkë: “Lumë sarajet kë kanë mbrenda//Kanë Ndue Gjonin me shtatë zemra!//Me shtatë zemra, me tri kokla(veshka)//Vranë Dodë Gjegjën, ju lumtë dora!”. Kjo do të thotë se i përmenduri “me 7 zemra” dhe “tri kokla” është Drangua që është i mbinatyrshëm dhe nuk e kap plumbi i pushkës, këtë e tregojnë numrat simbolik, magjik.

Numri tre ndër Shqiptarët përdoret më dendur në rite të ndryshme në magji të bardha: fatsjellëse e shëruese, të mbarësisë po edhe në magji të zezë: keqbërëse, për të sëmurë dikë, për të sjell grindje etj.

Formulat rituale magjike është e vështirë t’i gesh pa treshin si emërtim a në brendi.

Sh. Gjeçovi gjatë kërkimeve të tij të gjata e ka përcaktuar treshin si numër magjik të Shqiptarëve që del si i tillë në disa rite e besime gjithandej në trojet e kombit tonë. Ai shënon: *“Ndër hetime tridhet e ma vjetore qi bana tuj rrmue zembrën e kombit tem, si ndër male, si ndër rrafshë e qytete, mujta me e vërtetue se numri tre për shqypëtarin asht numër magjik dhe ma misterjoz. Mundet me pa në këtë e tjera dorëshkresat e mija, të botueme e të pabotueme se çë besim i jepet këtij numri, e qi të ndalet syni pa pasë nevojë me kërkue e me u lodhë, të gjitha ato sjellje që lypet të përsëriten tri herësh i kam nënvizue me plumç të kuq.”*. Pra është e vërtetë që Gjeçovi ka mbledhur mjaft rite, besime e mite në popullin tonë dhe se shihet qartë në disa shembuj përdorimi i numrit tre, por jo vetëm te populli jonë por edhe e popujt e Ballkanit, të Europës, të Azisë e më tej. (Tirta, 2004:374-377).

1.1 Shembuj nga numri tre në përralla:

Në Dukagjin: Natën e Buzmit në mesnatë:

*“...Si të shtrohet lami kështu, hin (burri) në mjedis të lamit merr bukën e pathyeme në dorë e tuj ndejë mbë kambë me bukë para durësh, e hjedh përpjetë **tri herësh** sa të mundet edhe e pret ndër duer. Po ra mbarë buka me shkrola e lajle sypri, ka për të kenë vjetë (pjelluer) bereqeti; po ra mbarë një a dy herë, vjeti ka për të kenë me pak pësim, por së ra mbarë as’i herë, ka për të kenë vjetë zijet. Tue e hjedh bukën i zoti i shpisë thotë çdo herë: “Falna zot bereqetin”. Mandej merr përsëri at bukën edhe e rrokullis napër lam prej një skajit në tjetër krye e këtë punë e ban **tri herësh**, po ra mbarë buka vjen bereqeti, po ra mrapë asht vjetë zijet. Edhe carokun e djathit e hjedh si bukën, porse jo aq nalt, e tuj thanë “ falna zot bereqetin!”, **Tri herë** e hjedh djathin, po ra mbarë vjet pjelluer ka për të kenë, për ndryshe vjet i zis. Djathi nuk rrukulliset nëpër lam si buka...”*

Këtu forca mistike shprehet me bukën dhe djathin, po në anën tjetër në këtë ritual në lëmë një rol të posaçëm mistik e luan treshin me përsëritjen e veprimeve gjithnjë tri herë.

Shkodër, 1925:”*Kush të ket lezat, a ndër duer a në fytyrë, të shkojë me ndesh mbë ndonji njeri me kalë të bardhë e t’i thonë **tri herë** “O ti trim me kalë të bardhë, //m’i merr lezat qi mkan dalë!” Atbotë pështyn **tri herë** lazat”. Besohet së kështu ata hiqen dhe është i pranishëm edhe treshi me mistikën e tij.*

*“Me ba me i kap tri vjetat fëmija pa folë, e fusin në thes dhe ja ngarkojnë një lypanikut mbi shpinë, i cili ai i bie rreth **tri herë** shtëpis duke thanë “Fol deh si foli une” , “Ligjro deh si ligjroj unë” , mbas së cilës sjellje besohet se fëmija do të flet.”*

Gjithashtu Gjeçovi na ka dhënë edhe shumë rite që i ka mbledhur në lidhje me këtë numër kulturi për ti ndaluar fatkeqësitë, sëmundjet :

*“Mëzatit të ri të cilit do ti vehet zgjedha së parit, i zoti i bie qafës me një gurrë **tri herë** kinse të mos ti prishet qafa e mos ta qesë gjuhën jashtë kur të ngitet n’arë. Kjo sjellje kryhet prej të zotit të mëzatit me gojë mbyllë.”*

*“Zogun e parë të pulës, porsa të dalin prej vovej e pa pështet aspak në tokë, e merr në dorë grueja edhe përshkon **tri herësh** nëpër birë të rrethit të vargonit të zjarmit të mos tu bjerë lija pulave”*

Gjithashtu kemi edhe shfaqe të trinisë së shenjtë të paganizmit, në disa raste ndeshim edhe figura të mitologjisë shqiptare, në disa rrëfenja mitike ashtu si dhe në rite magjike. Këto

mbijetesa që kanë ardh deri në kohën tonë shek XX në mite e figura mitike, janë shumë të shndëruara po në thelbin e tyre ruajnë dhe disa elementë thelbësorë, të kësaj natyre janë : *Tri Zanat*.

Në besimet popullore paraqiten bashkë në shpellë mes një pylli të dendur tri Zana bashkë: *Zana e madhe, Zana e mesit, Zana e vogël*.

Në rrëfenja mitike, po dhe në element mitikë të përrallave veprojnë : *Tre Divat, Tre Viganët, Tre Katallajt*, kemi edhe raste të tjera të kësaj natyre : *Tre Motrat, Tre Bijat e Mbretit, Tre vëllezërit, Tre bijtë e Mbretit*.

Me interes gjithashtu është të vërehet edhe gjendja e kësaj natyre në shpellën e Kreshnikëve. Aty janë mbyllë Mujo dhe Halili dhe Shaban Evimadhi ose në disa versione tjera: Mujo, Halili dhe një Shkja. E natyrshme do të ishte që aty të ishte vetëm Mujo dhe Halili por doemos në tërë rrëfenjat mitike do të na dalin tre.

Në përrallën “Qerosi vret Kuçedrën” :

Nji baba qi kish tre djem, prej të cileve më i vogli ish qeros. Kur vdiq ati i tyre u la trashëgimi tre këlliçe...(Kultura popullore 1999:3-4)

Në përrallën “ Zgjuarsia e Qerosit” :

Kisha tri pushka dy të prishme, një pa shul. Mora atë pa shul. Ika më tej. Mora tre zagarë, dy të ngordhë, një pa shpirtë. Mora atë pa shpirtë dhe ika ta gjuaj atje. Ishin tri laraska, një iku, një krisi, një fluturoi. Ma tej gjeta tre lepuj. Dy i plagosa, një e vrava. Mora atë të vramin. Ika më tej gjeta tri shtëpi. Ato ishin dy të shëmbuara, njëra pa çati. Hyra në atë pa çati. Ishin tri plaka, dy të vdekura, njëra pa shpirtë, pyeta atë pa shpirtë, :”Oj plakë, desha një kusi të ziej mishin”. Plaka: “Ruj mor bir, në atë qoshe atje ka kusia” : atje ishin tri kusi, dy të prishme, një pa fund... (Kultura popullore 1999:4)

Në përrallën “Gjali me klishat ene motra ugurzezë” :

...Gjali e bën dorën me xhakin e kulshedrës, ja ven caucës mun n’ballë xhi ti dale touta. Cauca i thët:

-M’ka kurtalis ki gjali, me kët de martohem.

Kejt katouni jon çudit, ujtin n’katoun vejn trej ditë e trej netë xhak pi kulshedrës. Gjali shkon n’katoun martohet me caucën bajnë darsëm t’madhe...”(Selimi-Osmani 2017:18)

Në përrallën “Vllaj e’xhallën motrën me tëmbilin e zënave” :

*Ka kë në një nënë ka pas çija **tre** cauca. Buri i ka thonë grujes:*

-Me u bë upe caucë dë t’mbajti.

*Nëna e caucave bën llaf me bijat e veta ju kallzon. Këtejne u dhembet shaum nona. Kur vejnë vakti nona t’boje, i marrin pelenat ene shkojnë n’mal. Agje e bën nëna gjalin. Ndalet cauca e madhe me një krroj t’mbushje uj ta lajnë gjalin. Atej vejnën **tre** dervejsh. Njëni ka than:*

-hajde de mejsim çashtej.

I diti thët: -Më be kur de bëhet sinet athere.

I treti thët:

-Hë be de e lëmë kur dë martohet...(Selimi-Osmani 2017:27)

*...Kur liv gjali, kur shkova te proj më dulen **tre shtriga, tre pqaka**, njëna thot ta mbajtim e dita tha jo, prajt kur dë bëhet sinet, **e treta** thët kur dë martohet...(Selimi-Osmani 2017:28)*

*...Ah, motra ka vdek për mou un dë shkoj te lin e perndon dilli, une motrën dë ta n’xhalli. Kur shkoj vllaj ke dilli atej i dulën **tre cauca** t’heshme ene e pejtën...*

... O dill, tre amaneti i kam.

Dielli i thët hë kallzo.

*-Kur erdha termo **tre caucat** më than që tët pajsë pse nuk ju del kismet... (Selimi-Osmani 2017:29)*

Në përrallën “Amaneti i grues ene mieqkat”

*Kan shku **tre gra** për kiselica/ nju ona grue ka qi en me barr// T’u shku audhës ka pas balt e madhe/ ene kjo gruja qish ka qi en me bar/ ka met ke balta/ ato dy qjerët kan dal ene kan shku/ kiet e kan lan vet// Kaur/ ja vjen mi eqka// Gruja i lutet mi eqkes te qi ese pi ke balta/ mi eqka i thot: / dë t’qies po t’ma apish besën ce si t’bo ujsh gjal de majsh për vete/ si t’bu ojsh cauc de ma apish mauve// Gruja ja ep besën mi eqkes/ ene mi eqka e qiet pi ke balta// Ene ksaj grues i len cauc// Cauca raitet e madhe/ kjo ene ma s’ja ep mi eqkës (Ibrahimi 2017:17)*

Në përrallën “Pepellashka” :

*Kan shku **tre cauca** ke zalli t’lajn liesh// Ato kan than kush da mese e mrapna nana e vet di boet lu op// Dy shu oqet e kan lajt li eshin ma para/ kjo e treta ka met// Kaur shkon kjo nishpai/ nana e vet o boka lu op// Baba e ksaj o martau me grue qjetër// Kjo shkon ke arri te shofe nanën e vet// Nana e vet i thot bijes/ kaur de therin për mish/ kjo t’ja mli edhe kocit ene*

t'ja qu oje ke rranja e trenafilit/ ene t'lutet qish t'dete di plotsoet lutja// Mas ni vakti/ e therin lu opën/ a bija i mli edh kocit ene i qon ke rranja e trenafilit// Si e therrin lu opën/ kju o metet jetaime/ pa nan/ metet me njerken// Njerka s'e don kiet/ ajo e don bijën e vet// Njerka di el lun me bijën e vet/ a kiet e len t'raje ke votra/ i thot te përzie ajnin// Ni dit boet ni dasëm n'kataun/ njerka e merr bijën e vet ene shkon n'dasëm// Si shkon njerka n'dasëm/ kjo cauca shkon ke trenafili ku i ka lan kocit/ i lutet nanës vet// Nana e vet ja bon ni qere e mair/ dy kual...(Ibrahimi 2017:18)

Në përrallën “ Tre motra ene qiraxhju”

*Kan qienun **tre motra** ene ato kan pletajtun nalt/ a posht kan pas qiarxhi// Bëba vet/ ka dal ernjet përjashta// Para ce t'shku oje u ka thanën: / du la po t'rajni mrenda/ pash neni zrypi ke qiraxhju/ acere majeni fort ka than baba// D'vi la **tre rize**/ kujt di nxajet rizja/ ajo ka zryp posht ke qiraxhju// Ene ksajs e madhes i bije shtiza posht/ ene kjo i kërtilet/ thot o qiraxhi nama shtizën?// Ai thot/ aun s'ta ap/ zryp mere vet// Ajo prap i thot/ nama// Ai prap jo// Kjo i thot/ nama ce de t'boj copa// Ene ai pi frayke ja ep// Ene e dytës i bije shtiza posht/ ene kjo i thot/ nama shtizën// Qiraxhju i thot/ ec mere vet...(Ibrahimi 2017:23)*

Në përrallën “Hasoni mbret ene kulshedra” :

*...Prejt ni dit,di,**tre dit** arousha s'erdh n'shpell.Ene kjo, dushkë teposhtë me drapnin e babës n'dorë e ja mrejni në shpej t'babës...(Selimi-Osmani 2017:31)*

Në përrallën “Hëzri ene tre vllaznit” :

*Kan konë **tre vllazën**, mirpo ata kan kon fukara, s'kan pas kurnise as për t'hongër.*

Nji ditë kan bo llaf njoni me qetrin vllaznit, si de rohet halli.Vllaj ma i madh ka thonë:

-un de i lutem zotit kit kto sorrat t'mi boje dhen ene t'mi jape mu, t'mundem t'roj.Vllaj i ditë rrejñ kijtohet ene thotë:

Une di lutem zotit të më ape mollë, pak hajvonat ene trroj mejrë.

*Ki **i treti** thotë: une dë i lutem allahit të më ape pak mollë, pak hajvonat sa t'bohem idajre. ...*

(Selimi-Osmani 2017:43)

Në përrallën “Nousja- zhelkë me hijen honën e zdronte” :

*Ka qonë çish ka qonë.Kan qonë me ni vakët **tre vllazën**.Di kan qonë t'martoum i treti ka met pa martou... (Selimi-Osmani 2017:55)*

Në përrallën “Kismetin i trea vllaznive” :

*Ka kon xhi ka kon. Ka kon me ni shpoj **tre vllazën**, tu trea pa martae. Ni dit atoa vendosin t’a luan xhilihonen. I marën tu **tra shkopejt** n’ dorë ene i fugjin. Çali shkoap xhilihan, në çalën der dë shkoje ataj gjali da kese kismetin... (Selimi-Osmani 2017:79)*

Në përrallën “Guri ndër guhë i xharpnit” :

Ka konë nihere ni nënë ene ni gjal.

*Nëna i thët gjalit t’ shkoje n’ gurbet se je bo burrë. Amo i ep me vete sëlde **tre pare**. Ki gjali tu hec udhës i shef do caull tu e rreh ni çen... (Selimi-Osmani 2017:83)*

Në përrallën “Nëna me tre caucat ene aufja” :

*Ka kë në xhi ka kë në. Ka kë në ni grue xhi ka pas **tre cauca**. Nji dit i thotë një nës caucë -Shko mi bijë, çaj pak dru se nëna kë më gjëftej me punët qera... (Selimi-Osmani 2017:96)*

Në përrallën “Përrallë me keca” :

*Gjyshja e mbante mend si sod atë pushkën me të cilën pati shkuar për gjah i gjyshi, një pushkë e gjatë **tri pashë**, që mbushej nga gryka e që i thoshin nëse nuk gabohem, shishane... (Shuteriqi 1987:17)*

Në përrallën “Se kam fjalën për çdo ceremoni”:

*Thoshin se Markezit i kishin dërguar edhe **tri buallica**, që të hante kosin e tij të preferuar. Kjo, sigurisht që një shaka të tjerat qenë siç i tregova... (Shuteriqi 1987:41)*

1.2 Shembuj nga numri tre në balada :

Baladat shqiptare e kanë të tyre treshin simbolik, mistik dhe jo pak vargje ato fillojnë me treshin.

Në Vithkuq të Korçës: “**Kemi tre** vjet që punojmë, // Dot në këmbë stë qëndrojmë, // Po punojmë aty **tre** vëllezër, // Që të ngrehin urn’ e e zezë”

Në Malsinë e Gjakovës: “**Tre** t’hasjanë kan ra n’ Gjakovë, // Do hallate po i punojnë, // Mirë hallatet i kanë punue, // Urn’ e Shejtë e kanë tfillue, // **Tre** muej ditë kishin punue, // Puna mbarë su pashka shkue, // Diçka natën ja u ka rrxue”

Përdorimin e treshit e kemi edhe tek ndërtimi i Kalasë së Shkodrës: “*I ra mjegulla Bunës, // Ndej tri ditë e ndej tri net, // Mbas tri ditsh e mbas tri netsh, // Fryni një freski e hollë, // e naltoi – o mjegullën // e naltoi der n’Valdanuz, // Ku punojshin tre vllazën, // Tre vllazën të Krishten*”

Në baladën e Tanës jepet miti çudibërës, fatsjellës i muzikës, i melodisë së fyellit në variantin e Gjinarit të Elbasanit vërejmë tre bari që kanë tre fyej: “*Ishte i fushë e gjatë e e gjanë, // Ishin tre bari me gja, // Kishin tre fije në brest, // Kur i bishin fyllit parë, // çohshin gjaja me ngran barë, // kur i bishin fyllit dytë, çohshin gjaja me ngran krypë, // Kur i bijshin fyllit tret, // Çohshin gjaja me pi vetë*”.

Gjithashtu edhe tek Arbreshët e Italisë e gjejmë dendur përdorimin e numrit tre magjik: “*Tha triherë: O Konstantin!, // Konstantin o birthi jim, // Ku është besa që më dhe? // Vdiekje e vate edhe nën dhe?*”¹

Pra formula **me tri** paska forcë të depërtojë edhe te i vdekuri dhe ta ngjallë atë.

Tek vepra me balada shqiptare të Anton Pappleka gjetëm mjaftë shembuj që pikërisht lidhen me numrat mitik siç i kemi shembujt:

Nuk duhet të flaç me mua

Tre vjet e tre muaj,

Tre orë e tre minuta....

....

Gjika na e mbajti kushtin

Edhe nuk i foli nuses

Tre vjet e tre muaj,

Tre javë e tre ditë,

Tre ditë e tre orë...(Pappleka 2005:24)

Edhe tek balada “Dashi i zi” vazhdimisht përmenden vetëm tre vëllezër dhe tri motra :

Tre vëllezër e tri motra

Ishin me kopenë në mal.(Pappleka 2005:46)

Gjejmë tek balada e Jeronim De Radës “Duall dielli ka malet...” të botuar në Rapsodi të një poeme shqiptare, përsëri të përdorur numrin tre si numër kulturi :

Trim i dritëm e i bukur

Si mputhe të parëzën

Puthëm edhe të ditën.

Tri herë u më e putha,

Tri herë vetëmese i ftesa; .(Papleka 2005:60)

Gjetëm të përdorur edhe në baladën “*Arapi e Mujo Halili*” numrin tre, që është një cikël këngësh që i hasim shpesh numrat e kultit :

Tri vjet gjamën ia kan ndie,

Tri vjet gjamën tuj gjimue (Këndoi me lahutë Frrok Gj. Gjakova (Papleka 2005:63)

Tek balada “Halil Garria” të mbledhur nga Marin Sirdani e gjejmë numrin tre:

Për në marrsh vesht ti zojt e malit,

Për tri vjet ke shpia s'mbrrijmë .(Papleka 2005:73)

Tek balada “Konstandini dhe Zarza” :

Konstandin, o vëlla i parë,

Hajt na merr Zarzën me parë!

Se tri vjet rruga larg,

Për tri ditë bie në ftua. (Papleka 2005:76)

Këtë shembull që e gjetëm tek balada “Kishin qan tre vllazën bashkë...” e kemi edhe tek murrosja e gruas tek Kalaja e Rozafës në Shkodër :

Kishin qan tre vllazën bashkë,

Kishin marrun tredhet ostallar

...

Kur të bahet e treta ditë

Bini dialin të m'pain zit.(Papleka 2005:89)

Balada “Rozafati”:

Çi ra njegulla Buenës!

Ndej tri ditë e ndej tri net

Mbas tri ditësh e mbas tri netsh...(Papleka 2005:90)

Shembuj të numrit tre gjejmë edhe te një baladë “Tre T’hasjanë kanë ra n’Gjakovë” që pikërishtë ka të bëjë me murimin në një urë :

Tre t’hasjanë kanë ra n’Gjakovë

...

Tre muej dit kishin punue

...

Të tre vllaznit ishin tmartuem

Të tre te ura kokan shkue.(Papleka 2005:95)

Vazhdimi i murimit në urë :

Kemi tre vjet që punojmë (2) (Papleka 2005:99)

Balada e gjetur për murimin në kishë që titullohet “Qenkeshin tre vëllezër...”, këtu përdoret edhe numri tre por edhe numri nëntë si numra kulturi :

Qenkeshin tre vëllezër,

...

Bir, në qofshi tre me besë

Nuseve të mos u rrëfeni.

...

Unë kam nëntë vëllezër

Të nëntë ia lajnë me flori (Papleka 2005:103)

Në baladën e gjetur tek vepra e Anton Papleka të quajtur “Bejlegu ndërmjet dy vllazënve të panjoftun” gjejmë të përdorur numrin tridhjetë, tre:

Se njëzetekatër vjeç djali asht

E tash tri herë në bejleg ka dalë

Bejlegxhit tash tri herë i pret

E tridhetë vjeç, ti Hyso, je ba

...

Po më ndigjoni, tridhetë kapidana

...

Tridhetë çika tu çezmja na i gjet

...

Tridhetë çikat djalit po i kallxojn(Papleka 2005:153-154)

Në baladën “Konstadini i vogëlith...” ku kemi rrinjohjen e burrit me gruan e gjejmë numrin tre:

Konstandini i vogëlith,

Tri dit dhëndërrith!(Papleka 2005:169)

Balada “T’enjten mbrama u martova” :

Të m’apë mezil-dorinë,

Për tri dit’ ta marr Ylqinë.

...

Për tri dit’ e mriu Ylqinin.(Papleka 2005:173)

1.3 Shembuj nga numri tre në lirikat shqiptare :

Në ciklin e Kreshnikëve dukuritë mitike zënë një vend të rëndësishëm, si dhe treshi me funksione mistike, në tërë variantet e Ciklit ishte në fillim një bari i pafuqishëm dhe Zanat i dhanë tri herë të pijë qumësht nga gjiri i tyre e nga kjo u bë i fuqishëm. Në variante tjera i japin tri herë nga tri lule barnash për t’u thithur lëngun: nga thithja e këtij lëngu bëhet njeri me fuqi të madhe. Herojtë e ciklit janë shumë të fuqishëm si jepet në disa raste të veçanta, nga tre gjarpërinj e nga këta e marin forcën. Muji pasi e vret kundërshtarin i hap barkun për të parë ku e kishte forcën : “*Be ka ba Gjeto Bashë Muja: // Nuk e la pa e çilë në barkë, // Ja ka gjet tre zemra në barkë, // Ja ka gjet tre toksa në barkë, // Nja ish kanë ma kuq se gjaku, // Nja ish kanë ma zi se korbi, // Nja ish kanë ma bardhë se bora, // Qai i ziu kish pa lëftue, // se dy tjerët në gjumë kin pa’qillue, // Kanë britë Mujës Zanat e veta, // Ty Mujë zoti të vraftë, // Se treqind herë shpirti me të hi, // Treqind herë shpirtin ta nxjerin, // Tridhet zhgjeta nshtrat mi kanë vringllue... // Tri herë në zemër, besa m’kanë ligshue”.*

Në “*Martesa e Mujit*” në majë të malit janë tre mrize ku jetojnë zanat dhe kur të kalohet andej nuk duhej të bëhej zhurmë se në rastë të kundërt ata do të zanojnë të bëjnë gurrë a kërcujë ose të marin për tu shërbyer atyre për tre vjet në mesin e pyllit.

Kemi edhe disa raste kur nuk përmendet numri tre por rradhiten bashkë tri mallkime, tri urime, tri veprime, tri porosi çka duhet kuptuar simbolika e treshit si rrënjë e forcës së misterit.

Nganjëherë në rite a në veprime me karakter magjik në vend të treshit del shumëfishi i tij: nëntë, tridhjetë, treqind, tremijë e tjerë. Kështu kemi 30 agë, 300 agë, rrapit 300 vjeç, tridhjetë çika për 30 djem që i martojnë. Numrat e përdorur e ndonjë tjetër si këta vlerat magjike i marin nga treshi, ka raste kur treshi ndonjëherë përmendet bashkë me shtatën, nëntën dhe dymbëdhjetën.

Shembujt që shënohen më poshtë kanë lidhje me përmbajtjen e krijimit të Lidhjes së Prizrenit që pikërisht nëpërmjet këngëve e kemi kuptuar të vërtetën për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, ku pikërisht gjatë analizës së këngëve hasim edhe përdorime të shumta të numrave të kultit shqiptar ku në këngën e parë që titullohet “Në Prizren kish ra rrufe” kemi numrin tre:

*Me ‘izet e shtat’ gusht, sahati **tre**,*

Në Prizren kish ra rrufe:

Me të shtimet e kapaklisë,

Ish vra telegrafisti i Turqisë.

E kish vra një trim lumnjan,

Dan Zaskoci i kan’ pas’ thanë. (Kultura popullore NR 1-2, 1998 fq.179)

Në këngën “Kurvelesh e Gegëri” përdoren dy numra kulturi :

Kurvelesh e Gegëri

Ç’u mblodhën në Ergjëri

Ky Abdyl bej Frashëri

Ç’u përpoq, i varfëri,

*Çkriu **tri barrë** flori,*

***Shtatë** herë në Frëngji.* (Kultura popullore NR 1-2, 1998 fq.187)

Kënga “Lshoe Gjakovën se t’zuni sherri :

Ymer Prizreni, trim shqiptar,

Sylejmani, ni komanar,

*I tubuen **tre** mi luftarë...(Kultura popullore NR 1-2,1998 fq.189)*

Kënga “Bini djem të bajm’ gajret” :

...

Çak prej gardhit po bjen burija,

Po lifton Hasan Haxhija,

*Çe **tri dit** p’e rreth topxhia*

*Çe **tri dit** e **çe tri net***

Hasan aga po pisket (Kultura popullore NR 1-2,1998 fq.191)

Or prill be vlla

*nam nja **tre dit** ua*

jem i treti vet

t’ja b«j plakës

si di vet(Ibrahimi 2003:32)

Shaj - shaj bubullaj

Erdhi plaka në mullaj

*Boni **tre kulaç**, i p^uoq n’aj*

Nj^uonën e p^uoq,

nj^uonën e d^uogj

q’etrën e dajti për sh^uoq (Ibrahimi 2003:37)

Në këngën “Trandafil në ferrë” :

...

Vera jerdh e shkaj,

Shyshja nuk pushoj,

Trandalin në kaç

***Tre jarana** paçë,*

Besën sun u dhashë ooo ih (Selimi-Osmani 2007:21)

Në këngën “Vili vili raskupili” :

...

Gajlen pranverës hiç s’ja kam.

*Mart or vlla, a mi jep **trej dit** uha,
Sa ta mbajti pëqakën me gjith xhi ka.*

...

*Mort he vlla,
Gjem **tre ditë** uha*(Selimi-Osmani 2007:41)

Në këngën “Njo di *tre*” :

*Njo di **tre**,
Mejni u m’çe.
Kush e *xhin* çe.*(Selimi-Osmani 2007:55)

Në këngën “I limina dili mina”:

*I limina, dili mina,
Tre llaç kukullaç
Tre musul gjelda, ...*(Selimi-Osmani 2007:55)

Në këngën “Ama mana *tri* za” :

*Ama, mana
Tri za, zoti ka,...*

...

*Ana mana, dana mana.
Tri za, zoti ka* (Selimi-Osmani 2007:57)

Në këngën “T’parën not’ dost” :

*T’parën not’ dost,
Ditën not shoç,
Tretën not llost.*(Selimi-Osmani 2007:62)

Në këngën “O kasap me asni pejka t’zezë n’ball” :

...

*Ti bajsh selam ataj kasapit qetër,
Me **tre pejka**, t’zeza n’ballë* (Selimi-Osmani 2007:64)

Në këngën “ Tre here fkata me zo” :

Tre here fkata me zo,
He more bizele...(Selimi-Osmani 2007:79)

Në këngën “Kënga e kalasë së Shkodrës” :

Ç’po punojshin tre vllazën

Murin e qytetit –o

Shkon ni plak – o

Aty pari:

Puna e mbarë, o ju tre vllazën!

Ku po e shef ti mbarrën tonë:

Gjithë ditën po punojmë e gjithë natën po na rrënohet.

A din gja, plak, me na diftue

Kjo kala që nuk shtërngon?

Un e di po kam gjynah.

At gjynah ti lena ne.

Kish qitë plaku e u kish thanë:

A jeni të tre të martuem?

A i keni të tre vashat?

Po, n’a t’re vashat i kena

Na difto, na, çka me ba

Si me ngrehun kët kala?

Pa ndigjoni, ju tre vllazën:

Për në daçi drejt me punue

Porosin që po ju nap kuj mos shkoni me i diftue...(Taipi 1998:15)

Në këngën “Kënga Ali Borxh Alisë” :

Mos t’mëndodhshin kumbara e uzdaja,

Brendë në burg patën me m’shti,

Për qefilë mue, nanë,

Ata më kan hi,

Për tri javë’ un paret me ju la,

Treqind qese, nan,

Un kam me i marë,

T’tanë me shitë, nanë

*Un mallin e gjanë,
Treqind qese, nanë,
Un smund ti baj..
...**Teqind qese** na borxh i kem me i la,
Gjaja e malli pra ka me na mbet
Nusen prap, bir, kam me ta marrë... (Taipi 1998:19)*

Në këngën “Ku keje lulija hanëm”
*Ku keje lulije hanëm, kur shkove terma,
Di **tri her** t'fishkllova pse s'më dhe zo...(Bexheti 2012:23)*

Në këngën “Ngata krejen”
*...Do ta marr Emin dilberin,
çe **tre vjet** e due...(Bexheti 2012:23)*

Në këngën “Nxheshi cauca”
*...Çomi shkusët Sherif aga,
Tre dit para javës,
Se jam ma e bukra
Shko diftoj nonës,
Çomi shkusët Sherif aga
Tre dit para t'honës...(Bexheti 2012:105)*

Numrin tre e hasim të përdorur edhe në dramën “Juda Makade” të Gjergj Fishtës :

*...Por sa vegoj sot drita,
Ushtrinë unë nluft e qita
E prej **tri anësh** më shpejt i mësyva Makabejtë..
...Me pas njerzit nga **tri zemra**
Drue sthehet Makabeu....(Fishta 2005:24)*

2 Kuptimi i numrit tre në situata të caktuara (përalla, balada, lirika popullore)

Potenciali leksiko semantik i numrit tre:

Nr	Tre	Kuptimi	Shembulli
1	1	2	3
1.	Tri herësh (3)	Tregon shumfish, veprimtari të përsëritur	<p>1. e hjedh përpjetë tri herësh sa të mundet edhe e pret ndër duer...</p> <p>2. Mandej merr përsëri at bukën edhe e rrokullis napër lam prej një skajit në tjetër krye e këtë punë e ban tri herësh...</p> <p>3. e merr në dorë grueja edhe përshkon tri herësh nëpër birë të rrethit të vargonit të zjarmit të mos tu bjerë lija pulave”...</p>
2.	Tri here (9)	Tregon veprimtari të përsëritur disa herë. Tregon thënje ose shprehje të përsëritur që kanë binjde mitologjike. Në shembullin e tetë tregon që personi ka arrit pjekurin dhe është i gatshëm të del në dyluftim.	<p>1. Tri herë e hjedh djathin, po ra mbarë vjet pjelluer ka për të kenë, për ndryshe vjet i zis...</p> <p>2. të shkojë me ndesh mbë ndonji njeri me kalë të bardhë e t’i thonë tri here</p> <p>3. !”Atbotë pështyn tri herë lazat”.</p> <p>4. i cili ai i bie rreth tri herë shtëpis duke thanë</p> <p>5. i zoti i bie qafës me një gurrë tri herë kinse të mos ti priset qafa e mos ta qesë gjuhën jashtë kur të ngitet n’arë</p> <p>6. “ Tha triherë : O Konstantin</p> <p>7. Trim i dritëm e i bukur Si mputhe të parëzën Puthëm edhe të ditën. Tri herë u më e putha, Tri herë vetëmese i ftesa;</p>

			<p>8. <i>Se njëzetekatër vjeç djali asht</i> <i>E tash tri herë në bejleg ka dalë</i> <i>Bejlegxhit tash tri herë i pret</i> 9. <i>Tre here fkata me zo,</i> <i>He more bizele...</i></p>
3.	Tre këlliçe	Tregon sasi, pasuri	<i>1.Kur vdiq ati i tyre u la trashëgimi</i> <i>tre këlliçe..</i>
4.	Tri pushka	Tregon sasi, nënçmim	<i>1.Kisha tri pushka dy të prishme, një</i> <i>pa shul.</i>
5.	Tri laraska	Sasi	<i>Ishin tri laraska, një iku, një krisi,</i> <i>një fluturoi</i>
6.	Tri shtëpi	Sasi	<i>Ika më tej gjeta tri shtëpi.</i>
7.	Tri plaka(2)	Sasi, ulje vlerash Te shembulli i dytë shpreh krahasim për të nxjerrë veti të këqija në pah.	<i>1.Ishin tri plaka, dy të vdekura,</i> <i>njëra pa shpirtë, pyeta atë pa shpirtë.</i> 2.... <i>Kur liv gjali, kur shkova te proj</i> <i>më dulen tre shtriga, tre pqaka,</i>
8.	Tri kusi	Sasi, nënçmim	<i>atje ishin tri kusi, dy të prishme, një</i> <i>pa fund...</i>
9.	Tri ditë (11)	Besime mitologjike, afat kohor, largësi – distancë, Tregon një ngjarje që ka ndodh për një kohë të shkurtër, kërkesë	<p>1.<i>Kejt katouni jon çudit,ujtin</i> <i>n'katoun vejn trej ditë e trej netë</i> <i>xhak pi kulshedrës.</i></p> <p>2....<i>Prejt ni dit,di,tre dit arousha</i> <i>s'erdh n'shpell</i></p> <p>3.<i>Ndej tri ditë e ndej tri net</i></p> <p>4.<i>Mbas tri ditsh e mbas tri netsh</i></p> <p>5.<i>Edhe nuk i foli nuses</i> <i>Tre vjet e tre muaj,</i> <i>Tre javë e tre ditë,</i> <i>Tre ditë e tre orë...</i></p> <p>6. <i>Konstandin, o vëlla i parë,</i> <i>Hajt na merr Zarzën me parë!</i> <i>Se tri vjet rruga larg,</i> <i>Për tri ditë bie në ftua.</i></p> <p>7.<i>Çi ra njegulla Buenës!</i> <i>Ndej tri ditë e ndej tri net</i></p>

			<p><i>Mbas tri ditësh e mbas tri netsh...</i></p> <p>8. Konstandini i vogëlith, Tri dit dhëndërrith</p> <p>9. Të m'apë mezil-dorinë, <i>Për tri dit'</i> ta marr Ylqinë.</p> <p>...</p> <p><i>Për tri dit'</i> e mriu Ylqinin</p> <p>10. Çak prej gardhit po bjen burija, <i>Po lifton Hasan Haxhija,</i> Çe tri dit p'e rreth topchia</p> <p>11. Mort he vlla, Gjem tre ditë uha</p>
10.	Tri netë (4)	Besime mitologjike, afat kohor, largësi – distance,	<p>1.Kejt katouni jon çudit,ujtin n'katoun vejn trej ditë e trej netë xhak pi kulshedrës.</p> <p>2.Ndej tri ditë e ndej tri net</p> <p>3. Mbas tri ditsh e mbas tri netsh</p> <p>4. Çi ra njegulla Buenës! <i>Ndej tri ditë e ndej tri net</i> <i>Mbas tri ditësh e mbas tri netsh...</i></p>
11.	Tre vajza (5)	Shpreh mallkim- fatkeqësi, bukuri të shumfisht, bestytyni, aktivitet i përsëritur,	<p>1. Ka kë në një nënë ka pas çigja tre cauca.</p> <p>2.Kur shkoj vllaj ke dilli atej i dulën tre cauca t'heshme ene e pejtën...</p> <p>3. -Kur erdha termo tre caucat më than që tët pajsë pse nuk ju del kismetit...</p> <p>4. Ka kë në ni grue xhi ka pas tre cauca.</p> <p>5.Kan shku tre cauca ke zalli t'lajn liesh// Ato kan than kush da mese e mrapna nana e vet di boet lu op// Dy shu oqet e kan lajt li eshin ma para</p>
12.	Tre dervish	Sasi	Atej vejnën tre dervejsh
13.	I treti (3)	Kur i referohet vetës së	1.I treti thët:

		tretë	<p>2. <i>Ki i treti thotë:</i></p> <p>3. <i>Kur të bahet e treta ditë</i></p> <p><i>Bini dialin të m'pain zit</i></p>
14.	Tre shtriga	Shpreh krahasim për të nxjerrë veti të këqija në pah.	<i>...Kur liv gjali, kur shkova te proj më dulen tre shtriga, tre pqaka,</i>
15.	Tre vëllezër (8)	Sasi frymorësh, kohë , gjendje, veprim , përkatsi fetare,	<p>1. <i>Kan konë tre vllazën, mirpo ata kan kon fukara, s'kan pas kurnise as për t'hongër.</i></p> <p>2. <i>Kan qonë me ni vakët tre vllazën</i></p> <p>3. <i>Ka kon me ni shpoj trea vllazën, tu trea pa martae.</i></p> <p>4. <i>Po punojmë aty tre vëllezër,//</i></p> <p>5. <i>Ku punojshin tre vllazën,// Tre vllazën të Krishten”</i></p> <p>6. <i>Tre vëllezër e tri motra</i></p> <p><i>Ishin me kopenë në mal.</i></p> <p>7. <i>Kishin qan tre vllazën bashkë, Kishin marrun tredhet ostallar</i></p> <p>8. <i>Ç'po punojshin tre vllazën</i></p> <p><i>Murin e qytetit –o</i></p> <p><i>Shkon ni plak – o</i></p>
16.	Tre shkopinj	Sasi	<i>I marën tu tra shkopejt n'dorë ene i fugjin</i>
17.	Tre pare	Vlerë	<i>Amo i ep me vete sëllde tre pare</i>
18.	Tri pashë	Figur stilistike Hiperbola, vlerë	<i>Gjyshja e mbante mend si sod atë pushkën me të cilën pati shkuar për gjah i gjyshi, një pushkë e gjatë tri pashë</i>
19.	Tri buallica	Sasi faune	<i>Thoshin se Markezit i kishin dërguar edhe tri buallica</i>

20.	Tre vjet (6)	Afat kohor, largësi - distancë, aktivitet kohor, vështirësi	<p>1. <i>“Kemi tre vjet që punojmë</i></p> <p>2. <i>Nuk duhet të flaç me mua</i> <i>Tre vjet e tre muaj,</i> <i>Tre orë e tre minuta....</i></p> <p>3. <i>Tri vjet</i> gjamën ia kan ndie, <i>Tri vjet</i> gjamën tuj gjimue</p> <p>4. <i>Për në marrsh vesht ti zojt e malit,</i> <i>Për tri vjet ke shpia s’mbrijmë</i></p> <p>5. <i>Konstandin, o vëlla i parë,</i> <i>Hajt na merr Zarzën me parë!</i> <i>Se tri vjet rruga larg,</i> <i>Për tri ditë bie në ftua.</i></p> <p>6. <i>Kemi tre vjet që punojmë</i></p>
21.	Tre t’hasjanë (2)	Pushtues	<i>“Tre t’hasjanë kan ra n’Gjakovë</i>
22.	Tre muaj(4)	Afat i gjatë kohor, vështirësi	<p>1.Tre muej ditë kishin punue</p> <p>2.Nuk duhet të flaç me mua <i>Tre vjet e tre muaj,</i> <i>Tre orë e tre minuta...</i></p> <p>3. <i>Edhe nuk i foli nuses</i> <i>Tre vjet e tre muaj,</i> <i>Tre javë e tre ditë,</i> <i>Tre ditë e tre orë...</i></p> <p>4. <i>Tre muej dit kishin punue</i></p>
23.	Tre bari	Kapital, pasuri	<i>Ishin tre bari me gja</i>
24.	Tre fije	Lloj brezash	<i>Kishin tre fije në brest</i>
25.	Tre orë	Afat kohor,	<p><i>Nuk duhet të flaç me mua</i> <i>Tre vjet e tre muaj,</i> <i>Tre orë e tre minuta....</i></p>
26.	Tre minuta	Afat kohor,	<p><i>Nuk duhet të flaç me mua</i> <i>Tre vjet e tre muaj,</i> <i>Tre orë e tre minuta....</i></p>
27.	Tre orë	Afat kohor,	<i>Edhe nuk i foli nuses</i>

			<i>Tre vjet e tre muaj, Tre javë e tre ditë, Tre ditë e tre orë...</i>
28.	Tre motra (2)	Vendndodhje, punë,	<i>1.Tre vëllezër e tri motra Ishin me kopenë në mal. 2.Kan qienun tre motra ene ato kan pletajtun nalt/ a posht kan pas qiarxhi// Bëba vet/ ka dal ernjet përrjashta// Para ce t'shku oje u ka thanën:</i>
29.	Tre	Kohë fikse – datë, orë, vend	<i>Me 'izet e shtat' gusht, sahati tre, Në Prizren kish ra rrufe:</i>
30.	Tre barrë	Mund, vështirësi	<i>Ky Abdyl bej Frashëri Ç'u përpoq, i varfëri, Çkriu tri barrë flori,</i>
31.	Tre mijë	Forcë, aftësi	<i>Ymer Prizreni, trim shqiptar, Sylejmani, ni komanar, I tubuen tre mi luftarë...</i>
32.	Tre jarana	Urim,	<i>Vera jerdh e shkaj, Shyshja nuk pushoj, Trandalin në kaç Tre jarana paçë, Besën sun u dhashë ooo ih</i>
33.	Tre pika	Kërcënim	<i>Ti bajsh selam ataj kasapit qetër, Me tre pejka, t'zeza n'ballë</i>
34.	Tre zemra	Dëshirë,mungesë besnikërie	<i>...Me pas njerzit nga tri zemra Drue sthehet Makabeu....</i>
35.	Tre gra	Sasi, vështirësi ,	<i>Kan shku tre gra për kiselica/ nju ona grue ka qi en me barr// T'u shku audhës ka pas balt e madhe/</i>
36.	Tre rize	Bestytini, punë	<i>D'vi la tre rize/ kujt di nxajet rizja/ ajo ka zryp posht ke qiraxhju//</i>

3 Klasifikimi i leksemave për numrin tre

Rasti tjetër më i shpeshtë nga tregime shqiptare popullore është emri për numrin tre. Këtu janë klasifikimi dhe rishikimi i të gjitha leksemave me të cilat ky numër qëndron:

- 1.Një periudhë e caktuar kohore - ditë (20) natë (7), java (2), muaj (2), viti (9), orë (2).
- 2.Njerëz:Motër (2), vëllezër (13), plaka (2), dervish (1), vajza (5), bari (1),jarana (1), t'hasjanë (2), llaç (1), grua (1),
- 3.Njësitë sasiore: - herë (17), para (1), pashë (1) , pika (1),
- 4.Elementet faune: - laraska (1), zagarë (1), buallica (1), këlliçe (1),
- 5.Pjesë të trupit : zemra (1),
- 6.Produktet e aktiviteteve të njeriut: - shkopinj (1), kusi (1), pushka (1),
- 8.Elementet toponimesh:shtëpi (1).
- 9.Figura mitologjike : shtriga (1),
- 9.Të ndryshme: - barrë (1), fije (1), besë (1), musul (1), zë (2), vashta (1), anësh (1), peshqir (1), kulaç (1).

4 Numri tridhjetë

Këtë shembull që e gjetëm tek balada “Kishin qan tre vllazën bashkë...” e kemi edhe tek murrosja e gruas tek Kalaja e Rozafës në Shkodër :

*Kishin qan **tre vllazën** bashkë,
Kishin marrun **tredhet ostallar***

...

*Kur të bahet **e treta ditë**
Bini dialin të m’pain zit.(Papleka 2005:89)*

Në baladën e gjetur tek vepra e Anton Papleka të quajtur “Bejlegu ndërmjet dy vllazënve të panjoftun” gjejmë të përdorur numrin tridhjetë, tre :

*Se njëzetekatër vjeç djali asht
E tash **tri herë** në bejleg ka dalë
Bejlegxhit tash **tri herë** i pret
E tridhetë vjeç, ti Hyso, je ba*

...

*Po më ndigjoni, **tridhetë** kapidana*

...

***Tridhetë çika** tu çezmja na i gjet*

...

***Tridhetë çikat** djalit po i kallxojn(Papleka 2005:153-154)*

Në këngën “Halili çliron robinat” :

*Lum e lum për zotin të lumin,
Na sjem ken zoti na ka dhanë.
Kur jan ken agët e judbines*

***Tridhet në kuvend** ishin mbledhë...(Taipi 1998:38)*

Në këngën “Termeti në Shkodër në vjetin 1905”

Kështu tue ikë kryq e tërthuer

E për ne ma kush nuk pyetë,

*Dolnë me **tridhet n’tetuer...***(Taipi 1998:107)

Traidhjet dit ramazan

Ja Muhamed ja Mustafa

Sheri i Ramazanit - elvida

Sheri i Bajramit – meraba (Ibrahimi 2003:57)

5 Kuptimi i numrit tridhjetë në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore)

Potenciali leksiko semantik i numrit tridhjetë:

Nr	Tridhjetë	Kuptimi	Shembulli
	1	2	3
1.	Tredhjetë ustallarë	Sasi, vështirësi të ndonjë çështje	<i>Kishin qan tre vllazën bashkë, Kishin marrun tredhet ostallar</i>
2.	Tridhjetë vjeç	Mosha, aftësi	<i>Bejlegxhit tash tri herë i pret E tridhetë vjeç, ti Hyso, je ba</i>
3.	Tridhjetë vajza	Sasi, sugjerim	<i>Tridhetë çika tu çezmja na i gjet ... Tridhetë çikat djalit po i kallxojn</i>
4.	Tridhjetë	Sasi	<i>Na sjem ken zoti na ka dhanë. Kur jan ken agët e judbines Tridhet në kuvend ishin mbledhë...</i>
5.	Tridhjetë tetor	I referohet periudhës kohore	<i>Kështu tue ikë kryq e tërthuer E për ne ma kush nuk pyetë, Dolnë me tridhet n'tetuer...</i>
6.	Tridhjetë ditë	Afat të caktuar kohor	<i>Traidhjet dit ramazan Ja Muhamed ja Mustafa Sheri i Ramazanit - elvida Sheri i Bajramit – meraba</i>

6 Klasifikimi i leksemave për numrin tredhjetë

Rasti tjetër më i shpeshtë nga tregime shqiptare popullore është emri për numrin tredhjetë. Këtu janë klasifikimi dhe rishikimi i të gjitha leksemave me të cilat ky numër qëndron:

- 1.Një periudhë e caktuar kohore – tetorë (1), ditë (1)
- 2.Njerëz: ostallarë (1), çika (2),
- 3.Njësitë sasiore: - vjeç (1),
- 4.Elementet faune: -
- 5.Pjesë të trupit :
- 6.Produktet e aktiviteteve të njeriut: -
- 8.Elementet toponimesh:kuvend (1).
- 9.Figura mitologjike :
- 9.Të ndryshme:

7 Numri treqind

Numri treqind që pikërisht zë një vend të rëndësishëm në numrat e kultit e gjejmë të përdorur edhe në baladat shqiptare si p.sh tek balada “Çika Potureshë” :

*Ia kish dhanun paj **treqind duket,***

Për dy javë orokun p’e dajn,

...

***Treqind krushq-e** shpejt m’i ka thirrë,*

***Tre tupana** njaty i ka goditë...(Papleka 2005:31)*

Tek balada “E bija e begut Allaj Beg” e gjejmë numrin treqind :

***Treqind krushq** me veti m’i ki pasë(Papleka 2005:31)*

Në këngën “Kur dola te gjuri bardh”:

...

Kur dola te gjuri bardh’

***Treçin lule** kishin dal.(Selimi-Osmani 2007:53)*

Në këngën “Hajde nuse te na se kena boll” :

...

E kina n’oborr, në fund të shkallve.

***Treçin duj** i çitsha pi ni are... (Selimi-Osmani 2007:174)*

Në këngën “Kënga Ali Borxh Alisë” :

Mos t’mëndodhshin kumbara e uzdaja,

Brendë në burg patën me m’shti,

Për qefilë mue, nanë,

Ata më kan hi,

*Për **tri javë**’ un paret me ju la,*

***Treqind qese,** nan,*

Un kam me i marë,

T’tanë me shitë, nanë

Un mallin e gjanë,

Treqind qese, nanë,
Un smund ti baj...
...Treqind qese na borxh i kem me i la,
Gjaja e malli pra ka me na mbet
Nusen prap, bir, kam me ta marrë... (Taipi 1998:19)
... treqind në nuse i kin dhanë
Nuk po don Alija me e dhanë...
...treqind n'nusen mi kan dhanë...
...të qofshin falë ty treqind dyket
Ka marrë vllau o, motrën e vet,
Qofshim miq na për treqind vjet...(Taipi 1998:20-21)

Në këngën “Shqetë rrethojnë kullën e Mujit” :

Gjith 'rreth kulla shqie ish ken rrethue,
Treqind topa kullës ja kin vue...(Taipi 1998:33)

Në këngën “Muji merr lajkën e bardhë” :

Kundrejt maxharit tek paska dalë,
Paska njeh kullat e maxharisë
Treqind kulla n'ë maxharri i paskan dalë... ..(Taipi 1998:35)

Edhe numrin treqind e hasim tek drama “Juda Makabe “ e Gjergj Fishtës :

Unë gati kam treqind.
Atëhere me çeta t'mia
Do prita sa ti za (Fishta 2005:40)

8 Kuptimi i numrit treqind në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore)

Potenciali leksiko semantik i numrit treqind:

Nr	Treqind	Kuptimi	Shembulli
1	2	3	3
1.	Treqind duket	Vlerë, pasuri	<p><i>1. Ia kish dhanun paj treqind duket, Për dy javë orokun p'e dajn,</i></p> <p><i>2. ...të qofshin falë ty treqind dyket Ka marrë vllau o, motrën e vet, Qofshim miq na për treqind vjet...</i></p>
2.	Treqind krushq (2)	Sasi, mburrje	<p><i>1. Treqind krushq-e shpejt m'i ka thirrë</i></p> <p><i>2. Treqind krushq me veti m'i ki pasë</i></p>
3.	<i>Treqind lule</i>	Habi nga sasi e madhe	<p><i>Kur dola te gjuri bardh'</i></p> <p><i>Treqin lule kishin dal</i></p>
4.	Treqind duj	Nxjerrje në pah të vetive, vlerave të në toke	<p><i>E kina n'oborr, në fund të shkallve.</i></p> <p><i>Treqin duj i çitsha pi ni are...</i></p>
5.	Treqind qese (3)	Mospërmbushje premtimi , kërkesës	<p><i>1. Ata më kan hi, Për tri javë' un paret me ju la, Treqind qese, nan, Un kam me i marë,</i></p> <p><i>2. T'tanë me shitë, nanë Un mallin e gjanë, Treqind qese, nanë, Un smund ti baj...</i></p> <p><i>3. ...Teqind qese na borxh i kem me i la, Gjaja e malli pra ka me na mbet Nusen prap, bir, kam me ta marrë...</i></p>

6.	Treqind nuse	Nxjerr në pah vlerat e një nuse	... treqind në nuse i kin dhanë Nuk po don Alija me e dhanë... ... treqind n'nusen mi kan dhanë...
7.	Treqind vjet	Hiperbol, sasi kohore	...të qofshin falë ty treqind dyket Ka marrë vllau o, motrën e vet, Qofshim miq na për treqind vjet ...
8.	Treqind topa	Pushtim, rrethim , gjendje e vështirë	Gjith 'rreth kulla shqie ish ken rrethue, Treqind topa kullës ja kin vue...
9.	Treqind kulla	Sasi	Kundrejt maxharit tek paska dalë, Paska njeh kullat e maxharisë Treqind kulla n'ë maxharri i paskan dalë...

9 Klasifikimi i leksemave për numrin treqind

Rasti tjetër më i shpeshtë nga tregime shqiptare popullore është emri për numrin treqind. Këtu janë klasifikimi dhe rishikimi i të gjitha leksemave me të cilat ky numër qëndron:

- 1.Një periudhë e caktuar kohore – vjet (1),
- 2.Njerëz: dukët (2), krushq-e (2), nuse (2),
- 3.Njësitë sasiore: - treqind (1)
- 4.Elementet faune: -
- 5.Pjesë të trupit :
- 6.Produktet e aktiviteteve të njeriut: - topa (1),
- 8.Elementet toponimesh:kulla (1),
- 9.Figura mitologjike :
- 9.Të ndryshme: - lule (1), qese (3), duj (1),

1. Numri shtatë dhe karakteristikat e tij

Numrin shtatë e vërejmë në shumë raste si një numër të shenjtë, magjik, por që nuk ka aq peshë të madhe sa numri tre. Në legjenda mitike e në elementë mitikë të përrallave, në besime të ndryshme, mbështetur në legjenda, vërejmë: *Shtatë Vëllezërit*, *Shtatë divat*, *Shtatë të urtët*. Kemi dhe figurën mitike “*Shtatë pllamë mjekër e tri pllamë shtat*”, “*Kemi kuçedrën me 7 krerë.*”

Aty këtu ky numër paraqitet si nismë etimologjike, fillimi prej nga del forca e dukurive të ndryshme pra dhe ekzistenca e tyre.

Në poezitë legjendare, si dhe në rite, është e dukshme shtata mistike, për të shprehur forcën, të mbinatyrshmen. Njeriu me shtatë zemra është dragua, është i mbinatyrshëm.

Shtata është mbarësi e pjellori në fëmijë, që shprehet dhe në rite të ndryshme. Në të vërtetë fuqitë e mëdha që vendosnin në shek. XIX e fillimi i shek. XX nuk kanë qenë shtatë, po më pak ose më shumë por në popull gjithnjë besoj se kanë qenë shtatë. Nga historianët përmenden pesë a gjashtë fuqi të mëdha që kanë vendosur për Shqipërinë, vetëm për Mirditën në mënyrë të veçantë.

Pra kulti i shtatës në këto raste në Mesjetë e deri në Kohë të Re është një dukuri mbarë ballkanike e më tej. (Tirta, 2004:377-378)

1. 1 Shembuj nga numri shtatë në përralla:

Flokshën buzë Drinit: *“Buzë Drinit një djalë i ri, bari po kulloste dhitë. Pau një Flokshë që dilte buzë Drinit e ngrohej në diell mbi shkamb. Me një marifet, bariu e zuni dhe e çoi në shpi të vet, nuse për vete. Për 7 vjet ajo nuk foli. Krye dy vjetsh ajo bani një djalë. Krye 7 vjetëve e shtrëngoi i shoqi ta bante të fliste, po ajo kurrësesi nuk e bani kët gja. Atëhere i shoqi bani kinse po priste fmijën. Kta e bani që ta detyronte gruen të fliste. Nga frika se po i pritej djali, ajo foli e tha “More në qafë me ket punë mue e veten! Sa vjet të rija pa folë, aq bajrakë(dhena) të Pukës do të sundonte djali jem. Unë ndejta 7 vjetë pa folë e djali jem ka për të qenë i parë në **shtatëbajrakë**”* Nga ky shkak Puka ka shtatë bajrak, shtatë dhena si e shpjegon besimi mitik i kësaj rrëfenje.

Në disa raste vërejmë edhe veçanti astrologjike lidhur me hënën e me gruan në kultin e shtatës psh: *“Kur duan të dalin nuse të bukura, po dhe për të lindur fëmijë marrin pak dhe nga vendi ku kanë rënë rrezet e hënës natën e **shtatë** të shëndreut dhe pak dhe që andej ku kanë rënë rrezet e diellit ditën e **shtatë** të qërshorit dhe i bashkojnë e ia lidhin nuses t’i mbajë me vete. Besojnë se kështu nuset do të bëhet të bukura si hëna e si dielli, po dhe do të lindin fëmijë.”*

Në disa raste fëmijët i pagëzojnë në ditën e shtatë pas lindjes.

Në poezitë legjendare, si dhe në rite, është e dukshme shtata mistike, për të shprehur forcën, të mbinatyrshmen. Njeriu me shtatë zemra është dragua, është i mbinatyrshëm. Muji e Ajkuna te Kreshnikët kanë **shtatë Omera** që u vranë me shqehë *“ Se **shtatëzemrat** Muji mi ka pasun, // një kah një me shpatë ja kam kërkue, // Se **shtatëdjelm**, në një vjet me ti falë Zoti, // **Shtatqind** vjetsh ty tu kanë ba, // Se i pret shpata e Gjeto Basho Mujit”*

Shtata është mbarësi e pjellori në fëmijë, gjë shprehet dhe në rite të ndryshme. Në të vërtet fuqitë e mëdha që vendosnin në shek. XIX e fillimi i shek. XX nuk kanë qenë shtatë, po më pak ose më shumë por në popull gjithnjë besojnë se kanë qenë shtatë. Nga historianët përmenden pesë a gjashtë fuqi të mëdha që kanë vendosur për Shqipërinë, vetëm për Mirditën në mënyrë të veçantë *“ Të **shtatëmalet** u çuen n’kamë // M’at Zadrimë po bie një gjamë, // Nuk jam koshi si m’kan thanë, // Jam Merdita si e la nam!”*

Në disa raste numri shtatë shërben për numërime fisesh e vëllazërish si psh : *Shtatë Banët e Kroacisë, Shtatë Banët e Bosnjes* gjëra që në legjenda shpjegohen si shtatë njësi popullsie të ardhura në ato vende herët – herët.

Pra kulti i shtatës në këto raste në Mesjetë e deri në Kohë të Re është një dukuri mbarë ballkanike e më tej.

Në përrallën “Vllaj e m’xhallën motrën me tëmbilin e zënave” :

*...A ke ndaj dënise tu bë llaf ne? Nauk ka thënë.Pi frejge i kan shku **shtat palë** gjersë... (Selimi-Osmani 2017:27)*

Në përrallën “Hëzri ene tre vllaznit” :

*...Hëzri thotë: duhet ta therni këtë gjalin xhi e kini **shtatë vjeçë**, me xhakin e ktaj gjalit mounën tëm shëndoshen... (Selimi-Osmani 2017:45)*

Në përrallën “Kismetit i trea vllaznive” :

...Hë, shtaj xhi o puna?

*Baba m’lipën ni pllom njer **shtat pllom** mjekr t’kese aj njeri... (Selimi-Osmani 2017:82)*

Në përrallën “ Guri ndër guhë i xharpnit”

*...Nëna, vejn n’shpej i kallzon gjalit.Ki gjali e ven gurin ndër guhë, ki guri, farë ti thaush bën.Ki i thët nënës shko tahi hej n’shpej.Menjhere shpeja bohet **shtat kat**... (Selimi-Osmani 2017:84)*

1. 2 Shembuj nga numri shtatë në balada :

Balada “Shtatë sahat e kokrriz e shi “:

Shtatë sahat e kokrriz e shi (Papleka 2005: 26)

Tek balada e njohur “Çika Potureshë” gjejmë këto shembuj :

Kur mish ardhun e po nata e darsmës,

Shtatë pendë kije po m'i gjen të premun

Kur kish ardhun Hasan aga n'shpi

Shtatë pendë kije po m'i gjen të premun (Papleka 2005: 31)

Në baladën “Djali Gjarpër”:

Ja ki dhanë si nuk munej me marrë

Shtat sahat rruga po na ban (Papleka 2005: 43)

Në baladën “Halil Garria”

Të nandë vllaznit vran shosho'jn

Shtatë vjet motra ndiej tuj kja

Shtatë vjet zogu tuj fluturue

Shtatë vjet vorri me besë të dhanë(Papleka 2005: 70-71)

Në baladën “Duro Jabanxhia”

Nuk vonon një çudë e ka gjetë

Ia çon zoti një lngatë të fortë

Shtatë varrë në shtat ju kan ba(Papleka 2005: 115)

Në baladën “Zana e vejë” :

Të dy calinat çatallue

Të dy langojt o tu u hungrove

As dy plluma tu flatrue

Shtat bjeshkë të nalta i kan kërkue(Papleka 2005: 122)

1. 3 Shembuj nga numri shtatë në lirikat shqiptare

Kënga e parë që titullohet “Në Prizren kish ra rrufe” kemi numrin shtatë :

Me ‘izet e shtat’ gusht, sahati tre,

Në Prizren kish ra rrufe:

Me të shtimet e kapaklisë,

Ish vra trelegrafisti i Turqisë.

E kish vra një trim lumnjan,

Dan Zaskoci i kan’ pas’ thanë. (Kultura popullore NR 1-2,1998 fq.179)

Kënga e dytë “Ka ni pashë’ me e myt’ për vjet” :

Kish ndodh’ pasha kryqali

Kish pas’ gisht me shtat’krajli...(Kultura popullore NR 1-2,1998 fq.180)

Në këngën “Shum’ asqer po qet pamporri “:

...

-Besa, shok’, nuk muj me folë,

Se m’ka ra do gjak në gojë,

Se m’ka ra do gjak në bark,

Shtat’ martina i kam në shtat.(Kultura popullore NR 1-2,1998 fq.188)

Në këngën “Sylejmani po pisket”

...

Kërset pushka, bje burija,

Shtat’ sahat po rreh topxhija!

Shtat’ sahat e hajmedet

Topi e pushka po kërset! (Kultura popullore NR 1-2,1998 fq.190)

Në këngën “Vili vili reskopili” :

Vet jëm, kurkujt, dertin nuk ja këm

Shtat gjem i kom,
Shtatë nouse t'reja këm,
Vet jëm kërkujt dertin nuk ja këm,
Shtat lireka këm,
Shtatë gjepa këm,
Vet jëm, kurkujt, dertin nuk kja këm.
Shtat lop' pilleja i këm
Shtatçin dhen i këm (Selimi-Osmani 2007:41)

Në këngën “Mora oudhën e Elbasanit” :

...

Kur u ngrejta, vjeta s'xheta,
Po trejm çobanin e kishin vra,
Shtatë tetë pjuma, i kishin ra (Selimi-Osmani 2007:139)

Në këngën “Çish punonte ajshe honmi” :

Çish punonte Ajshe honmi, njer n'sahatin shtat?
Më puno oj lalulule dë marish ograk ... (Selimi-Osmani 2007:192)

Në këngën “Kënga e Ymerit djalit të Mujit” :

Pre i kam un dy mejdanxhi,
Krajlin në vend babë, e kam vrra,
Tremij pushkë përnjiherë më kan çue
E shtatë pushk Muji, që mi kan rra... (Taipi 1998:46)

Në këngën “Haxhi Alija lule xheneti”

...Tu shtatë zanat ikët e e latë.
Haxhi Alija shehit i detit,
Shpata yte lule xhenetit ...(Taipi 1998:64)

Në këngën “ Ç'po lufton Rexhep sokoli” :

...Mos kjaj nanë e mos kjaj grue,
Në gyrçarë jemi rrethue,
Në gyrçarë jemi rrethue,

Shtatë sahat kemi luftue

Shtat sahat e njizet dakika

Hajde hajde Himo Kika(Taipi 1998:98)

Në këngën “Aferim Veli Topalli”

*...Kur vojti **shtat sahati** natë,*

T’anë penxheret u ndezën flakë,

Lufton Velja si n’Karadak ...(Taipi 1998:99)

Në këngën “I gjallë Marku nuk po zihet”

Ky kurtlamë tuj mjerue,

*Për **shtatë kullat** qi i ka rrëzue*(Taipi 1998:105)

Në këngëm “More Nuri Aga”

*Pusto Devrija mi ka **shtat sahat,***

Xhumin e natës, sën e baj rahat (Bexheti 2012:217)

2. Kuptimi i numrit shtatë në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore)

Potenciali leksiko semantik i numrit shtatë:

Nr	Shtatë	Kuptimi	Shembulli
	1	2	3
1.	Shtatë vjet (5)	Rezistencë, murrje, bestyttni, mit,	<p>1. Për 7 vjet ajo nuk foli</p> <p>2. Krye 7 vjetëve e shtrëngoi i shoqi ta bante të fliste, po ajo kurrësesi nuk e bani kët gja.</p> <p>3. Unë ndejta 7 vjetë pa folë e djali jem ka për të qenë i parë në shtatëbajrakë”</p> <p>4. ...Hëzri thotë: duhet ta therni kët gjalin xhi e kini shtatë vjeçë, me xhakin e ktaj gjalit mounën tëm shëndoshen..</p> <p>5. Shtatë vjet motra ndiej tuj kja Shtatë vjet zogu tuj fluturue Shtatë vjet vorri me besë të dhanë</p>
2.	Shtatë	Afat kohor, potencim i një kohe të gjatë	<p>1. nga vendi ku kanë rënë rrezet e hënës natën e shtatë të shëndreut dhe pak dhe që andej ku kanë rënë rrezet e diellit ditën e shtatë të qërshorit dhe i bashkojnë e ia lidhin nuses t'i mbajë me vete.</p>
3.	Shtatë zemra	Forcë, burrëri	<p>Se shtatëzemrat Muji mi ka pasun</p>
4.	Shtatë djem (2)	Forcë, shtëpi e madhe e fortë	<p>1. Se shtatëdjelm, në një vjet me ti falë Zoti</p> <p>2. Vet jëm, kurkujt, dertin nuk ja këm Shtat gjem i kom,</p>
5.	Shtatë male	Fuqi e madhe, rëndësi,	<p>Të shtatëmalet u çuen n'kamë</p>
6.	Shtatë palë	Frikë, mundim	<p>Pi frejge i kan shku shtat palë gjersë...</p>
7.	Shtatë pëllëmbë	Hiperbolë	<p>Baba m'lipën ni pllom njer shtat pllom mjekr t'kese aj njeri...</p>

8.	Shtatë kat	Kohë e shkurtër	<i>Menjihere shpeja bohët shtat kat...</i>
9.	Shtatë orë (7)	Afat kohor, besim i hershëm që punët nuk bëhen në errësirë,	<p>1. Shtatë sahat e kokrriz e shi</p> <p>2. Ja ki dhanë si nuk munej me marrë</p> <p>Shtat sahat rruga po na ban</p> <p>3. Kërset pushka, bje burija,</p> <p>Shtat' sahat po rreh topxhija!</p> <p>Shtat' sahat e hajmedet</p> <p>Topi e pushka po kërset!</p> <p>4. Çish punonte Ajshe honmi, njer</p> <p>n'sahatin shtat?</p> <p>Më puno oj lalelule dë marish ograk ...</p> <p>5. Shtatë sahat kemi luftue</p> <p>Shtat sahat e njizet dakika</p> <p>Hajde hajde Himo Kika</p> <p>6. ...Kur vojti shtat sahati natë,</p> <p>T'anë penxheret u ndezën flakë,</p> <p>7. Pusto Devrija mi ka shtat sahat,</p> <p>Xhumin e natës, sën e baj rahat</p>
10.	Shtatë pendë	Sasi	<p>Kur mish ardhun e po nata e darsmës,</p> <p>Shtatë pendë kije po m'i gjen të premun</p> <p>Kur kish ardhun Hasan aga n'shpi</p> <p>Shtatë pendë kije po m'i gjen të premun</p>
11.	Shtatë varrë	Breng e madhe	<p>Nuk vonon një çudë e ka gjetë</p> <p>Ia çon zoti një lngatë të fortë</p> <p>Shtatë varrë në shtat ju kan ba</p>
12.	Shtatë bjeshkë	Kërkim për një kohë të gjatë ku përdor numër kulti (shtatë)	<p>Të dy langojt o tu u hungrue</p> <p>As dy plluma tu flatrue</p> <p>Shtat bjeshkë të nalta i kan kërkue</p>
13.	Shtatë martina	Gjendje e rrëndë	<p>-Besa, shok', nuk muj me folë,</p> <p>Se m'ka ra do gjak në gojë,</p> <p>Se m'ka ra do gjak në bark,</p> <p>Shtat' martina i kam në shtat.</p>
14.	Shtatë nuse	Forcë, Shtepi e madhe	<p>Vet jëm, kurkujt, dertin nuk ja këm</p> <p>Shtat gjem i kom,</p> <p>Shtatë nouse t'reja këm,</p> <p>Vet jëm kërkujt dertin nuk ja këm,</p>

			<i>Shtat lireka këm,</i>
15.	Shtatë foshnje	Mburrje, trashigimi,	<i>Shtat gjem i kom,</i> <i>Shtatë nouse t'reja këm,</i> <i>Vet jëm kërkujt dertin nuk ja këm,</i> <i>Shtat lireka këm,</i> <i>Shtatë gjepa këm,</i> <i>Vet jëm, kurkujt, dertin nuk kja këm.</i>
16.	Shtatë djepa	Sasi	<i>Shtatë nouse t'reja këm,</i> <i>Vet jëm kërkujt dertin nuk ja këm,</i> <i>Shtat lireka këm,</i> <i>Shtatë gjepa këm,</i> <i>Vet jëm, kurkujt, dertin nuk kja këm.</i>
17.	Shtatë lopë	Pasuri	<i>Shtat lireka këm,</i> <i>Shtatë gjepa këm,</i> <i>Vet jëm, kurkujt, dertin nuk kja këm.</i> <i>Shtat lop' plleja i këm</i>
18.	Shtatë pushkë	Hiperbola,	<i>Krajlin në vend babë, e kam vrra,</i> <i>Tremij pushkë përnjherë më kan çue</i> <i>E shtatë pushk Muji, që mi kan rra...</i>
19.	Shtatë zana	Besime mitologjike	<i>...Tu shtatë zanat ikët e e latë.</i> <i>Haxhi Alija shehit i detit,</i>
20.	Shtatë kulla	Dështim	<i>Ky kurtlamë tuj mjerue,</i> <i>Për shtatë kullat qi i ka rrëzue</i>

3. Klasifikimi i leksemave për numrin shtatë

Rasti tjetër më i shpeshtë nga tregime shqiptare popullore është emri për numrin shtatë. Këtu janë klasifikimi dhe rishikimi i të gjitha leksemave me të cilat ky numër qëndron:

- 1.Një periudhë e caktuar kohore - muaj (2), viti (6), orë (9), vjeç (1),
- 2.Njerëz: bajrak (1), djem (2), martina (1), nuse (1) foshnje (1),
- 3.Njësitë sasiore: - palë (1), pëllëmbë (1), kat (1),
- 4.Elementet faune: - lop (1),
- 5.Pjesë të trupit : zemra (1), gisht (1),
- 6.Produktet e aktiviteteve të njeriut: - pushka (1), plumb (1),
- 8.Elementet toponimesh: male (1), bjeshkë (1), kulla (1),
- 9.Figura mitologjike : zana(1),
- 9.Të ndryshme: - djep (1), varr (1), pendë (2).

1. Numri nëntë dhe karakteristikat e tij

Nënta ka një kult të veçantë në popullin tonë, si numër magjik, i dashur për përdoruesit në traditë, në doke e zakone, në rite, në krijimtarinë popullore sidomos në balada, në këngët legjendare, gjithashtu numri nëntë ka lidhje me treshin dhe në disa raste përdoret bash me treshin dhe shtatën. Edhe pse në dukje të jashtme shfaqet si një numër i zakonshëm vërehet lehtë struktura e saj si numër fati.

Numri nëntë është përdorur edhe për të shëruar një sëmundje lëkure e quajtur rrebulli që shfaqet me njolla të bardha në fytyrë e në trup, plakat përdorin këtë formulë magjike që më vonë fëmijët e përdorin për lojë.

Elementë mitikë shoqëruar me numra kemi në përalla në rrëfime të ndryshme popullore me natyrë kulturi. Disa herë në to vërejmë nëntën, e tillë është dhe metamorfoza e djalit gjarpër. Forca e tij qëndronte në nëntë lëkurët e gjarpërit.

Në rite magjike për të lindur fëmijë ose grave për të mos u vdekur fëmijët, për shërime e mjekime magjike është në funksion simbolika e numrit nëntë, në fshatrat e malsisë së Tetovës por edhe në vise të tjera shqipëtare vërehet ky ritë.

Edhe te Arbërorët e Greqisë e në Arbëreshët e Italisë shfaqet dendur nënta në poezinë popullore si numër simbolik. (Tirta, 2004:379-382).

1. 1 Shembuj nga numri nëntë

*“Trim mbi trim ai Gjergj Elez Alia, // Qe **nandë** vjet **nandë** varra n’shtat m’i ka, // Veç ni motër natë e ditë te kryet, // Ia lan varrat me ata ujët e gurës **nandë** vjeçe, // Ia lan varrat me ata lotët e syve//”.*

*“Rrepullari, // Me **nanë** kamë, // Ke me **nanë**, // Met me tetë, // Met me shtatë, // Met me gjashtë, // Ke me gjashtë, // Met me pesë, // Met me katër, // Ke me katër, // Met me tre, // Met me dy, // Met me nja, // Ke me nja, // Met me asnja//.”*

Elementë mitikë shoqëruar me numra kemi në përralla në rrëfime të ndryshme popullore me natyrë kulturi. Disa herë në to vërejmë nëntën, e tillë është dhe metamorfoza e djalit gjarpër. Forca e tij qëndronte në nëntë lëkurët e gjarpërit.

Në interes është edhe krahasimi i bukurisë së vajzës, nuses me dritën e ndriçuesve të qiellit : *dielli, hëna, yjet si psh: Ftyra e saj ndritë si **nandë** diella.*

Në rite magjike për të lindur fëmijë ose grave për të mos u vdekur fëmijët, për shërime e mjekime magjike është në funksion simbolika e numrit nëntë, në fshatrat e malsisë së Tetovës por edhe në vise të tjera shqiptare vërehet ky ritë : *“Gruaja që nuk mbetet shpejt me barrë, ne gjoks mban të varur një amuletë e aty janë futur **nëntë gurëz** që janë marë nga **nëntë ura**. Pasi mbushet viti duke i mbajtur në gjoks i hedh në lumin e rrjedhshëm me besim se kështu në të ardhmen do të bëhej me barë dhe do të kishte fëmijë”*

Në fshatin Sellcë të Tetovës vjehrra ther një gjel dhe nga gusha e gjelit merr **nëntë gurëz** dhe i mbështjellll me leckë dhe i mban në gjoks reja duke besuar se kështu do ngelet me barë, kur gruaja ngelet me barë dhe kalojnë 3 muaj nga koha e shtatzanisë duhet tu tregoj **nëntë personave** se ajo është me barë dhe kështu barra do të jetë me e lehtë dhe foshnja do të jetojë.”.

Edhe te Arbërorët e Greqisë e në Arbëreshët e Italisë shfaqet dendur nënta në poezinë popullore si numër simbolik: *“**Nëntë** djem e **nëntë** nuse, // Të **nënta** me djem në duar.”*

Balada “Motra me nëntë vëllezër”:

Motivi i motrës me nëntë vëllezër, është një nga motivet më të lashta të baladave shqiptare, i cili është i shtrirë në të gjitha viset e banuara me shqiptarë, duke përfshirë edhe viset e Prilepit dhe Krushevës, ku kemi mbledhur tre variante të kësaj balade. Përmbajtja e kësaj balade shtjellohet rreth një familjeje të madhe (nëna, disa vëllezër, një motër). Me këmbënguljen e njërit prej vëllezërve (zakonisht të voglit), vajza martohet larg; të gjithë vëllezërit vdesin (në luftë) varianti arbëresh; ose nga ndonjë epidemi – variantet e tjera). Shpëton vetëm nëna që ta zhvillojë subjektin dhe motra që ishte e martuar larg dhe nuk dinte gjë se ç’kishte ndodhur në gjini. (Ibrahimi 2018 :5)

Në viset shqiptare kjo legjendë është e njohur me shumë emra, por të gjitha ata janë variante të këngës së dëgjuar të arbëresheve të Italisë, të cilët ruajnë një sfond kristian Konstantini i Vogëlith dhe Doruntina ose Garentina, në jug (Permet, Gjirokastër, Çamëri)

është i përhapur varianti me heronj kryesor Konstantini dhe Dhoqina. Kjo baladë njihet edhe me disa variante tjera. Deri tani janë regjistruar mbi 20 variante të këtij motivi (Fetiu 1981:46), kështu p.sh. në Malësinë e Veriut dhe në Mal të Zi, Maqedoni e Kosovë (deri në Bujanoc, Preshevë e Medvegjë) vëllai quhet Halil, ndërsa motra Fatë. Në krahinat qendrore vëllai e ka emrin Ali e motra Fatë. Në zonat tjera këta heronj dalin me variante tjera, si: vëllai Halil Garia – motra Fatë; vëllai Ali – motra Fatë; vëllai Hysen i vogël – motra Mejreme (Neziri, 2010:73), Në rajonin e Prilepit dhe Krushevës heronjtë në variantin e parë janë Iseni dhe Fatimja (Nadire Asani), në variantin e dytë janë Yseni dhe Anifja (Naxhij e Imeri) dhe në variantin e tretë të tri variantet janë Iseni (Yseni) dhe Fatimja. (Ibrahimi 2018:6)

Në variantin e arbëresheve Doruntina ka dymbëdhjetë vëllezër. Këta vriten në luftë. Te Dhoqina nëntë vëllezërit helmohen nga një përbindësh. Po në të gjitha variantet, në fund vdesin nënë e bijë. Te “Bleta Shqiptare” e Thimi Mitkos këtë legjendë e kemi në prozë (Plaka me nëntë djemtë). Po me këtë motiv është bazuar edhe Kadare në novelën mjaftë të bukur "Kush e sollti Doruntinen?".

Në të tri variantet e kësaj kënge në rrethin e Prilepit dhe Krushevës janë përshkruar 9 vëllezër që vdesin të gjithë nga kolera.(Ibrahimi 2018:7)

Balada “Motra e 9 ”vllaznive “ (varianti I)

E kan kërkau 8-9 kataune

Mos ki gajle ne jemi 9 vllazën

Ka prit - ka prit s'ka 9 vjet

I drejtoet laraskës

Moj larask e shkraume,

A i ke pa vllaznit tem?

A mi ki pa 9 vllazën?

...

Po erdhën nja 8-9 dervisha,

en ktau vdiqën

A mi motër ec terma shkallve,

nana nalt osht

...(Ibrahimi 2018 :18-17)

Balada “8□9 Vllazën ene motra” (varianti i II)

Paska – pas motra 8 9 vllazën

E kan dhan motrën large large

Largelarge 9 konaqe larg e kan martau motrën larg

ka prajt motra nant vjet nauk i ka shku asni

A kto ja ka rrok kuliera

...(Ibrahimi 2018 :19-20)

Balada “Vllaznit ene motra” (varianti i III)

Kjo tue yp shkallve kaur e ngjon nana vet thot:

O moj kulier, a s'u frayne me 9 birnët teme

Po çishtai vjen t'um marsh ene mau

Kjo thot: O nan, nauk jem kuliera

...

Po tay s'aun tët shajfte

9 birna i ka zakopajt

qiktau ke obori Ene qaq e di. (Ibrahimi 2018 : 21-22)

Balada e gjetur për murimin në kishë që titullohet “Qenkeshin tre vëllezër...”, këtu përdoret edhe numri tre por edhe numri nëntë si numra kult:

Qenkeshin tre vëllezër,

...

Bir, në qofshi tre me besë

Nuseve të mos u rrëfeni.

...

*Unë kam **nëntë vëllezër***

Të nëntë ia lajnë me flori (Papleka 2005:103)

Balada “Lart, te Çuka e një rrahu”:

E rrodhtin, e mbajtin

Nëntë dit’ e di vjet,

...

Ju bënë ej e mbajtin

Nëntë dit e di vjet,(Papleka 2005: 51)

Në baladën “Ish një ëmë shumë e mirë...”:

Erdh një vit kaq i rëndë

Çë i kuarti asaj zonjë

Nëntë bilt te një lugadh(Papleka 2005: 67)

Në baladën “Halil Garria” :

*Pse **nandë vllazën** na që jemi*

Veç një motër tjetër skemi,

Nandë dit udhë largë do ta apim

...

Nand dit udhë larg që don me dhanë?

Hajt moj motër! – i ka thanë

*Se për këtë besë, që ta kam dhanë,
Kur t'i mbushish plot nandë javë
Vjen Halili e të merr në të pam.*

...

***Të nandë vllaznit** vran shosho'jn
Shtatë vjet motra ndiej tuj kja
Shtatë vjet zogu tuj fluturue
Shtatë vjet vorri me besë të dhanë (Papleka 2005: 70-71)*

Tek kënga “Kënga e dhoqinës” :

*Të më çpiket një stëhi,
Me vrap mu hoth në kusi
Më helmoi djemt e mi,
Nëntë djem e nëntë nuse
Të nënta me djem në duar,
Nëntë djepe çmi përmbyse
Nëntë pajë çmi zhurite
Nëntë dyfeke çmi shite.(Papleka 2005: 74)*

Në baladën “Hanin bukë si dy vëllezër” ku kemi rinjohjen e vëllait me vëllanë :

***Nëntë zemra** më bën,
Të luftonjë me **nëntëqind** (3) (Papleka 2005: 151)*

Në baladën “Konstandini i vogëlith...” ku kemi rinjohjen e burrit me gruan :

*Qeverrisu e bukurëzë
Kam të rij **nende vjet**
Nende vjete enende dite
Ti e bukura më martone
Ai be nende vjet
Nende vjete e nende dite,
Mua e bukra mu martua
E të diele vë kurorë.(Papleka 2005:171)*

Në këngën “Aga Ymeri na u martue” :

*Unë t’pres –o për **nandë ditë**,*

*Për **nandë ditë** – o, për **nandë net...***

*...Se s’ash rrugë –o, për **nandë ditë** por*

*Asht rrugë – o për **nandë vjet** (Taipi 1998:22)*

Në këngën “Ban kuvend Ali Pasha”

Çka lumi që vjen zi,

Se ata kenkan djemt e mi,

Mbaroj kuçi e mali i zi

Nand bajrak e nand burri

Të tan shkinat jan ba zi.....(Taipi 1998:93-94)

Në këngën “Çka ka Rusi qi po dridhet”

Qyqja motër del në shkallë,

*Beqir aga me **nandë varra** ... (Taipi 1998:95)*

Në këngën “Prejta prejta”:

*Prejta prejta **çe nant muj**,*

Moll në xhep të rujta,

*Çe ban mollën , **çe ban xhepin***

Si dëm dajsh pi nanës(Bexheti 2012:94)

2. Kuptimi i numrit nëntë në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore)

Potenciali leksiko semantik i numrit nëntë:

Nr	Nëntë	Kuptimi	Shembulli
	1	2	3
1.	Nëntë vjet(8)	Afat kohor, rënkim, vuajtje, pritje	<p>1. “Trim mbi trim ai Gjergj Elez Alia, // <i>Qe nandë vjet nandë varra n’shtat m’i ka</i></p> <p>2. <i>Ia lan varrat me ata ujët e gurës nandë vjeçe</i></p> <p>3. <i>Qeverrisu e bukurëzë Kam të rij nende vjet Nende vjete enende dite Ti e bukura më martone Ai be nende vjet Nende vjete e nende dite, Mua e bukura mu martua</i></p> <p>4. <i>Unë t’pres –o për nandë ditë, Për nandë ditë – o, për nandë net... ...Se s’ash rrugë –o, për nandë ditë por Asht rrugë – o për nandë vjet</i></p>
2.	Nëntë varra (2)	Vuajtje, durim	<p>1. “Trim mbi trim ai Gjergj Elez Alia, // <i>Qe nandë vjet nandë varra n’shtat m’i ka</i></p> <p>2. <i>Qyqja motër del në shkallë, Beqir aga me nandë varra ...</i></p>
3.	Nëntë diella	Bukuri e tepërt e pa krahasueshme	<i>Fytyra e saj ndritë si nandë diella.</i>
4.	Nëntë gurëz	Besime të hershme popullore, që janë praktikuar nga njerëzit	<i>“Gruaja që nuk mbetet shpejt me barrë, ne gjoks mban të varur një amuletë e aty janë futur nëntë gurëz që janë marë</i>

			<i>nga nëntë ura</i>
5.	Nëntë ura	Besime të hershme popullore, që janë praktikuar nga njerëzit	“Gruaja që nuk mbetet shpejt me barrë, ne gjoks mban të varur një amuletë e aty janë futur nëntë gurëz që janë marë nga nëntë ura
6.	Nëntë persona	Besime të hershme popullore, që janë praktikuar nga njerëzit.	<i>kur gruaja ngelet me barë dhe kalojnë 3 muaj nga koha e shtatzanisë duhet tu tregoj nëntë personave se ajo është me barë dhe kështu barra do të jetë me e lehtë dhe foshnja do të jetojë.”.</i>
7.	Nëntë vëllezër (5)	Në të njëjtim varg kemi të përmendur dy numra kulturi (nëntë – shtatë), vlera të mira njerëzore	1. Unë kam nëntë vëllezër Të nëntë ia lajnë me flori 2. Pse nandë vllazën na që jemi Veç një motër tjetër skemi, Nandë dit udhë largë do ta apim ... Nand dit udhë larg që don me dhanë? 3. Të nandë vllaznit vran shosho'jn <i>Shtatë vjet motra ndiej tuj kja</i>
8.	Nëntë bilt	Fatkeqësi	<i>Erdh një vit kaq i rëndë</i> <i>Çë i kuarti asaj zonjë</i> Nëntë bilt te një lugadh
9.	Nëntë ditë (4)	Afat kohor, rënkim, vuajtje, pritje	1. Nëntë dit' e di vjet, ... <i>Ju bënë ej e mbajtjin</i> Nëntë dit e di vjet 2. Pse nandë vllazën na që jemi Veç një motër tjetër skemi, Nandë dit udhë largë do ta apim ... Nand dit udhë larg që don me dhanë? 3. <i>Qeverrisu e bukurëzë</i> Kam të rij nende vjet

			<p><i>Nende vjete enende dite</i> <i>Ti e bukura më martone</i> <i>Ai be nende vjet</i> <i>Nende vjete e nende dite,</i> <i>Mua e bukra mu martua</i> 4. <i>Unë t'pres –o për nandë ditë,</i> <i>Për nandë ditë – o, për nandë net...</i> <i>...Se s'ash rrugë –o, për nandë ditë por</i> <i>Asht rrugë – o për nandë vjet</i></p>
10.	Nëntë zemra	Hiperbolë, vullnet	<p><i>Nëntë zemra më bën,</i> <i>Të luftonjë me nëntëqind</i></p>
11.	Nëntë bajrak – nëntë burri	Arritje, mburrje	<p><i>Se ata kenkan djemt e mi,</i> <i>Mbaroj kuçi e mali i zi</i> <i>Nand bajrak e nand burri</i> <i>Të tan shkinat jan ba zi...</i></p>
12.	Nëntë muaj	Afat kohor	<p><i>Prejta prejta çë nant muj,</i> <i>Moll në xhep të rujta,</i></p>
13.	Nëntë dervish	Sasi	<p><i>Po erdhën nja 8 9 dervisha,</i> <i>en ktau vdiqën</i></p>
14.	Nëntë fshate	Sasi, mundim	<p><i>E kan kërkau 8 9 kataune</i></p>
15.	Nënte konake	Largësi, mundim	<p><i>Largelarge 9 konaqe larg e kan martau</i> <i>motrën larg</i></p>
16.	Nëntë brinjë	Pyetje, sasi	<p><i>O moj kulier, a s'u frayne me 9 birnët</i> <i>teme</i></p>

3. Klasifikimi i leksemave për numrin nëntë

Rasti tjetër më i shpeshtë nga tregime shqiptare popullore është emri për numrin nëntë. Këtu janë klasifikimi dhe rishikimi i të gjitha leksemave me të cilat ky numër qëndron:

1.Një periudhë e caktuar kohore - ditë (9), natë (1), muaj (1), viti (8).

2.Njerëz: persona (1), djem (5), nuse (1), vëllezër (5), bajrak (1), dervish (1)

- 3.Njësiti sasiore: - /
- 4.Elementet faune: - /
- 5.Pjesë të trupit : zemra (1), këmbë (1),
- 6.Produktet e aktiviteteve të njeriut: - /
- 8.Elementet toponimesh: gurë (2), urra(1), fshat (1), konak (1)
- 9.Figura mitologjike : /
- 9.Të ndryshme: - dyfeke (1), pajë (1), djep (1), bilt (1), burri (1),diell (1), varra (2), brinj (2),

1. Numri dymbëdhjetë dhe karakteristikat e tij

Është numër simbolik i fatit tepër i përdorur tek populli shqiptar, nuk është si treshi që përdoret në rite të ndryshme, nga zberthimi i shembujve të përdorimit dymbëdhjeta paraqet një numër fisnik të një natyre të veçantë lidhur me doke, me tradita.

Simbolet e nderit ndër shqiptarët duhet të jenë gjithnjë dymbëdhjetë si psh. familja duhet të ketë *12 filxhana, 12 lugë, 12 pjata, tryeza e bukës* bëhet gjithnjë për 12 veta.

Dymbëdhjeta në natyrën e saj kultike është numër i personifikimit i hiperbolave.

Gjithashtu e gjejmë edhe tek Muji ku Kulla e Mujit gjithmonë na shfaqet 12 kate, ku sipas të dhënave të etnokulturës së popujve as në Egjiptin e në Mesopotaminë e lashtë as në Greqin e Romën antike nuk ka pasur ndërtesa mbi tre a katër kate.

Kulti i dymbëdhjetës është më se i qartë në paraqitjen e disa bashkësive malësore ndër shqiptar me lidhje gjaku, pra 12 fiset e para, 12 vëllezëri, 12 shtëpitë e para prej nga paska zënë fillë ky apo ai fshat.Kjo deri tash vonë ka qenë në psikologjinë e malësorëve. (Tirta,2004:382).

1. 1 Shembuj nga numri dymbëdhjetë

“Në ndeshjen e Gjergj Elez Alisë me Bajlozin e Detit: “//12 pash në tokë u ngul topuzi!// 12pash përpyetë u çue pluhni!” (12 pashë domethënë mbi 20 metra, po kaq thellë në tokë nuk ngulen as bombat atomike).

Gjithashtu e gjejmë edhe tek Muji ku Kulla e Mujit gjithmonë na shfaqet 12 kate, ku sipas të dhënave të etnokulturës së popujve as në Egjiptin e në Mesopotaminë e lashtë as në Greqin e Romën antike nuk ka pasur ndërtesa mbi tre a katër kate.

Kulti i dymbëdhjetës është më se i qartë në paraqitjen e disa bashkësive malësore ndër shqiptar me lidhje gjaku, pra 12 fiset e para, 12 vëllezëri, 12 shtëpitë e para prej nga paska zënë fillë ky apo ai fshat. Kjo deri tash vonë ka qenë në psikologjinë e malësorëve. Kjo përmendet në Dibër, në Gurgurnicë, kur erdhën Hotët nga Dalmacia e zunë vend ku janë sot, gjetën aty “12 shtëpi”, sipas të dhënave shënuar nga Tomiq, fisi shqiptar i Këlmendasve në shek. XVII ndahej në “12 vëllazni”, në Lurë kishte 12 pleq që përfaqësonin 12 fise të Lurës. Duhet ditur se numri 12 për emërtim fisesh ka qenë i pranishëm dhe në popuj të tjerë të Ballkanit, si te Kroatët, në Bosnje, në Mal të Zi ku shënohet në burime të ndryshme se gjithnjë përfaqsimi në gjykata popullore a përfaqësues shtetërorë deri në fund të shek. XIX bëhej gjithnjë me 12 pleq me 12 gjygtarë, me 12 përfaqësues.

Gjithashtu kultin e numrit dymbëdhjetë dikush e ka quajtur të zanafillës biblike, ashtu si përforcues mund të jetë bërë edhe nga kurani se dymbëdhjetën e ka numër të shejtë, *“me 12 imamët e mëdhenj”*.

Në një pjesë të madhe të malsive shqiptare si në Mirditë, në Mat, në Dibër, në Kurbin, në Zadrimë etj. Në ndarjen e tokës së punuar të pyllit, të bjeshkës, vihet kufiri një gurë i gjatë ngulur në tokë e rreth tij, brenda në tokë vihen 12 gurë të vegjël që quhen *“dishmitarë”*, ka raste që në vend të 12 dëshmitarëve për lehtësi të vihen në tokë vetëm gjashtë.

Betimet për konflikte të rënda si për vrasje a përdhunime bëheshin me 12 betarë, në zgjedhjen e konflikteve të rënda si gjygtarë “pleq” në të drejtë dokesore merrnin pjesë 12 vetë.

Në Bukmirë të Mirditës njihet toponimi 12 Gurët e Barive, me ata gurrë janë përcaktuar të drejtat e 12 fiseve të Oroshit, për ta shfrytëzuar atë vend e për të mos pasur konflikte mes barinjëve. Këto gurrët në vetvete janë 12 pleq deshmitarë në një kuptim simbolik.

Te Bektashijtë ka disa rite e besime për Matemin, për 12 Ditët e Ujit që bien mbas Hashures. Në këto 12 ditë nuk pinë ujë as natën as ditën. Besojnë se në këtë ditë vinë shpirtrat e të vdekurve në shtëpi. Në netët e 12 Ditëve që u përmendën lënë gjithë natën dyert hapur që të hyjnë lirshëm shpirtrat në shtëpi.

Tek Shqiptarët ka legjenda mitike të lidhura me numrin dymbëdhjetë: *“Ke liqeni i Lurës...Del një dash i zi nga liqeni dhe ndërzen 12 dhen. Këto dhen mbas disa muajve banë 12 kigje, femna të zeza. Në krye të vjetit ka dalë dashi i zi prej liqeni kur dhentë me kigja ndodheshin aty afër bregut. Ka blegruë –be-be dhe 12 kigjet e zeza janë hedhun e zhdukun në fund të liqenit bashk me dashin e zi”*.

Në Labëri shejtanin e thërrasin me emra të ndryshëm. “Në përruan e Lithit dhe në përruan e Vakos rrin i “i paudhi”, “shejtanin”, “i dymbëdhjeti”. Duhet ditur që numri dymbëdhjetë përdoret gjithandej nëpër përralla popullore, fjalë të urta balada e legjenda si p sh: “Doruntina...kur vdiq i sprasmi djalë/shkuli flokët ajo mëmë “Bobo vdekje e shkreta vdekje,/ **dymbëdhjetë** bijë m’i more,/E nani kush mend t’e dije. Urtësi popullore : “Unë i mjeri me **12** pleq,/ Kuj t’ia prish e kuj t’ia ndreq!”.

Dymbëdhjeta pra është numër simpatik kulti, fisnikërie, madhështie ndër Shqiptarë, ashtu si dhe në popuj të ndryshëm të Ballkanit, të Europës.

1. 2 Shembuj nga numri dymbëdhjetë në balada :

Tek vepra e përmbledhur me balada nga autori Anton Papeka në baladën e titulluar “ E bukura e detit” e gjejmë numrin dymbëdhjetë si numër kulti :

Gjithë grurë, gjithë grurë,

Dimbëdhjetë nuse të bukura

...

Dimbëdhjetë xhinde deti(Papeka 2005:22)

1. 3 Shembuj nga numri dymbëdhjetë në lirikat shqiptare:

Në këngën rreth Lidhjes së Prizrenit e titulluar “ Mal’i zi asht çue n’kamë” :

*Mal’i zi asht çue n’kamë,
Shum’ asqera gadi po i ban,
Shum’ asqer, asqer të zi,
I paska bamun **dymdhet’mi**
Kur i bani **dymdhet’mi**,
I çoi fjal’ pashës n’Gusi...*

Në këngën “Moj ti çikë në atë kodër” :

*S’jamë e vogël jam tamam,
Matmi kriçet gjal’sa i kam.
Dimdhejtë pashë sall njana anë...(Selimi-Osmani 2007:250)*

Në këngën “Muji merr lajkën e bardhë”

*...Kundruell ullës Mujit i kanë dalë
Dymdhet ketsh kullën e ki pasë
Der ma tposhtrin shqiet ja kan rrxue
Aspak luftën Muji sju ka da ...(Taipi 1998:37)*

Në këngën “ Kënga e Ymerit djalit të Mujit” :

*...**Dymdhet popa** fjetun kemi gjatë
T’tanve kryet ti ke me u pre... ...
...**Dymdhet popa** fjetun i ka gjetë,
T’tanve Ymeri kryet u kish pre (Taipi 1998:43-44)*

Në këngën “U ul Shala e ra n’shtoj”

*Veç njaj i shkreti Marash Palë
Dymdheht plumat i kan ra
Hala shpirti si ka dal... ...(Taipi 1998:71)*

Në këngën “Dasho Shkreli nuk ban ma nana”

...Thujmi nanës jam varrue,

Dymdhetë pluma m'kan përshkue ...(Taipi 1998:84)

Në këngën “Hajredin Pasha” :

Heeeeeeeeeej

Malet e Dibres o mi kan ngrie te tanë

*Nuk jan pak por **12 mijë***

*Nuk jan pak por **12 mijë***(<https://www.teksteshqip.com/ermal-fejzullahu/lyric-1840279.php>)

2. Kuptimi i numrit dymbëdhjetë në situata të caktuara (përralla, balada, lirika popullore)

Potenciali leksiko semantik i numrit dymbëdhjetë:

Nr	Dymbëdhjetë	Kuptimi	Shembulli
	1	2	3
1.	Dymbëdhjetë pashë (2)	Hiperbolë	<i>1.12 pash në tokë u ngul topuzi!// 12pash përpyjetë u çue pluhni!” 2. S’jamë e vogël jam tamam, Matmi kriçet gjal’sa i kam. Dimdhejtë pashë sall njana anë...</i>
2.	Dymbëdhjetë imamë	Numër i shejt	<i>“me 12 imamët e mëdhenj”.</i>
3.	Dymbëdhjetë kigje	Sasi	<i>.Ka blegrue –be-be dhe 12 kigjet e zeza janë hedhun e zhdukun në fund të liqenit bashk me dashin e zi”.</i>
4.	Dymbëdhjetë pleq	Gjendje e rëndë, mjerrim	<i>“Unë i mjeri me 12 pleq,/ Kuj t’ia prish e kuj t’ia ndreq!”.</i>
5.	Dymbëdhjetë nuse	Pasuri	<i>Gjithë grurë, gjithë grurë, Dimbëdhjetë nuse të bukura</i>
6.	Dymbëdhjetë mijë (2)	Sasi, forcë	<i>1.Shum’ asqer, asqer të zi, I paska bamun dymdhet’mi Kur i bani dymdhet’mi, I çoi fjal’ pashës n’Gusi... 2. Malet e Dibres o mi kan ngrie te tanë Nuk jan pak por 12 mijë Nuk jan pak por 12 mijë</i>

7.	Dymbëdhjetë ketsh	Hiperbolë	...Kundruell ullës Mujit i kanë dalë Dymdhet ketsh kullën e ki pasë Der ma tposhtrin shqiet ja kanë rrxue
8.	Dymbëdhjetë popa	Numër i shenjt i përkatësisë fetare krishtere	... Dymdhet popa fjetun kemi gjatë T'tanve kryet ti ke me u pre... Dymdhet popa fjetun i ka gjetë,
9.	Dymbëdhjetë plumba	Sasi, rezistencë, gjendje e rrëndë	1. Veç njaj i shkreti Marash Palë Dymdheht plumat i kanë ra Hala shpirti si kanë dal... .. 2. ...Thujmi nanës jam varrue, Dymdhetë pluma m'kan përshkue ...

3. Klasifikimi i leksemave për numrin dymbëdhjetë

Rasti tjetër më i shpeshtë nga tregime shqiptare popullore është emri për numrin dymbëdhjetë. Këtu janë klasifikimi dhe rishikimi i të gjitha leksemave me të cilat ky numër qëndron:

1. Një periudhë e caktuar kohore - /
2. Njerëz: nuse (1), pleq (1), imam (1), popa (2), xhinde (1)
3. Njësitë sasiore: - pashë (3), mijë (4),
4. Elementet faune: - dhen (1),
5. Pjesë të trupit : /
6. Produktet e aktiviteteve të njeriut: - plumb (2),
8. Elementet toponimesh: /
9. Figura mitologjike : /
9. Të ndryshme: - ketsh (1), kigje (2).

1. Numri dyzet dhe karakteristikat e tij

Ky numër kult, në përgjithësi vërehet në rite, besime e veprime magjike që kanë të bëjnë me lindjen, me lehonin, me foshnjat, me vdekjen e me të sëmurë nga epilepsia a ndonjë sëmundje tjetër, pra në përgjithësi shënon sasi ditësh “ dyzet ditë” në raste të rralla shënon edhe sasi gjërash të ndryshme.

1. 1 Shembuj nga numri dyzet

Lehonia e gruas që zgjat dyzet ditë, është e mbushur me rreziqe e me besimet popullore, për dyzet ditë gruaja me foshnjën duhet të tymoseshin, e të bënin pak fytyrën, ballin me blozë për t’u ruajtur nga shpirtërat e këqij e sidomos nga shtrigat që mund ti dëmtonin. Me të njejtin besim në Myzeqe, në Malsinë e Tetovës këto dyzet ditë lehona e foshnja bëheshin me qemëz, për ta nxirrë fytyrën, gjithashtu në kohën kur lehona e lidh e rregullon foshnjën për dyzet ditë nuk duhet të flasë me njeri, në këto ditë gjithashtu lehona nuk duhej të kalonte nëpër arrat e bukës se si besohej dëmton prodhimin e ardhshëm. Ndalohej që lehona gjatë 40 ditëve të dilte jashtë natën se shuplakej nga shtrigat nga shpirtërat e këqinj, besoj se po të vdiste lehona gjatë këtyre dyzet ditëve e kishte derën hapur në parajsë se është pa mëkate, gjithashtu lehona këto dyzet ditë nuk duhet të lëvizte shumë e të punoj andej këndeje sepse besohej se fëmija do ti bëhej i lëvizshëm.

Edhe në vdekje dyzeta si numër kult zë një vend të veçantë. Në malsitë shqiptare besohej se kur vdes njeriu shpirti del nga goja dhe për dyzet ditë do ti shëtisë tërë vendet ku ka kaluar i vdekuri sa ka qenë gjallë, gjithashtu për dyzet ditë njerëzit as nuk marrin as nuk japin hua natën se nga një veprim i tillë mendohet se i vdekuri ua merr kismetin të gjallëve. Gjithashtu deri dyzet netë pas vdekjes nuk duhet të flej njeri në dhomën e të vdekurit por e lënë bosh se mendohet se shpirti i të vdekurit për dyzet ditë hynë e del në dhomë.

Edhe për të hequr sëmundje si ethe kronike “ ajo e tokës” e tjera, kryenin rite që kishte të bënin me numrin dyzet, kështu i sëmuri kur kishte ethe kronike lahej me 6 janar dhe të dyzetën ditë të Pashkës së Madhe me ujë të ftohtë. Fëmija që ka “sëmundjen e tokës

(epilepsi) mbahet dyzet ditë pa u njomur me ujë me besimin se kështu thahej “ ajo e tokës “ e të mos ngjiste në trupin e të sëmurit.

Në përrallën “Zgjuarsia e Qerosit” :

*...po tani, - thash, - më duhet djepi dhe tallagani.Edhe lajmërova **dyzet burra, dyzet sëpata**.Dolën në mal të bëjnë djepin.Mirpo nuk dilte.Kishte mbetë një copë, një bujashkl sëpate. Bërra djepin edhe teproi. Tani baba donte edhe ato të shpërgajave, tallaganet.Lajmërova dyzet burra, **dyzet gërshanë**... (Kultura popullore 1999:4)*

Në ngjarjet historike “Vrasja e Pitu Gullit”

*Pitu Gullin e vretën Tefik Çakrja i Vërbovcit, si aski er i turqve. A gjen Maloçka bashkpunonte me ate. Ashtau fuolet. Kaçak kan qen gjith kto, pi ke plot kataune. Daja Vait i Kolevcve nauk ka marr pjes mrenda ama ka qen njer me ato, si përforcim i kaçakve. Ka qien ni njeri pi Peshtalove ene ka ardhun në kataun ene ka marrur **40 vet** ene sot e kiet dit vorret i kanë përmi Braillovën ke ato ferët, t’u shku në Desov. Ene ai i Peshtalovës i ka vramun, me sert ka qien ai, ce sërplit. Me Maloçken traum ka pasun ene pi Jabollçajshite kto të Alimovsve ene dy vet pi Tërnovce ene ni njeri ka pas po nauk e di. Kaur duet të boet neni zallaum vijn pi ke katauni qjetër ene ato i vrasin, ose e kundërta. Ashtau e kan bo zolloumin, kto aqje, ato ktau. Demek mo dikton kush e ka bo, ce ato ma larg kan qien. (Ibrahimi 2017:85)*

Tek “Balada e Tanës”:

*Tanë oj moj, motra Tanë
Hajdutët lidhur më kanë,
Qen e zi seç ma vranë,
Ogiçin në hell ma kanë,
Dyzet rrunx tufën ma ndanë,
Mua skllav do të më marrnë.(Pappleka 2005: 109)*

Në këngën “Dasho Shkreli nuk ban ma nana”

Dasho Shkreli mos ta lamë,

Se n’Stambollë ja kam nie zanë,

*Se i ka pre **dyzet nizamë***

Njashtu jan more sit kan thanë.....(Taipi 1998:83)

2. Kuptimi i numrit dyzet në situata të caktuara(përralla, balada, lirika popullore)

Potenciali leksiko semantik i numrit dyzet:

Nr	Dyzet	Kuptimi	Shembulli
	1	2	3
1.	Dyzet burra	Sasi, forcë	<i>...po tani, - thash, - më duhet djepi dhe tallagani.Edhe lajmërova dyzet burra, dyzet sëpata.Dolën në mal të bëjnë djepin.</i>
2.	Dyzet sëpata	Sasi	<i>...po tani, - thash, - më duhet djepi dhe tallagani.Edhe lajmërova dyzet burra, dyzet sëpata.Dolën në mal të bëjnë djepin.</i>
3.	Dyzet gërshanë	Sasi	<i>Tani baba donte edhe ato të shpërgajave, tallaganet.Lajmërova dyzet burra, dyzet gërshanë...</i>
4.	Dyzet rrunx	Dështim	<i>Qen e zi seç ma vranë, Ogiçin në hell ma kanë, Dyzet rrunx tufën ma ndanë, Mua skllav do të më marrnë.</i>
5.	Dyzet nizamë	Veti të këqija, forcë,	<i>Dasho Shkreli mos ta lamë, Se n’Stambollë ja kam nie zanë, Se i ka pre dyzet nizamë Njashtu jan more sit kan thanë... ..</i>

6.	Dyzet vetë	Sasi	...në kataun ene ka marrur 40 vet ene sot e kiet dit vorret i kanë përmi Braillovën ke ato ferët, t'u shku në Desov.
7.	Dyzet vjet	Sasi, vështirësi, vuajtje	Ni gazdaric ke 40 vjetet ama vdu ojc. Kaur u dashurau me Ginon. Abe Ginoja car u bo. Abe kaur u stërvajten kto tonët. Ayn bajn pi ke zadruga gjith gjon, gjith dit. Ajo vdiste për Ginon.

3. Klasifikimi i leksemave për numrin dyzet

Rasti tjetër më i shpeshtë nga tregime shqiptare popullore është emri për numrin dyzet. Këtu janë klasifikimi dhe rishikimi i të gjitha leksemave me të cilat ky numër qëndron:

- 1.Një periudhë e caktuar kohore - ditë (9), natë (2), vjet (1)
- 2.Njerëz:burra (1), nizamë (1),
- 3.Njësitë sasiore: - vetë (1),
- 4.Elementet faune: /
- 5.Pjesë të trupit : /
- 6.Produktet e aktiviteteve të njeriut: - sëpatë (1), gërshanë (1),
- 8.Elementet toponimesh:/
- 9.Figura mitologjike : /
- 9.Të ndryshme: - rrunx (1),

PËRFUNDIMI

Për të mos parashikuar të ardhmen , na nevojiten analiza të situatës së sotme dhe të kaluarës. Kurse këto analiza ne sot nuk i kemi. Ne thjesht sot nuk dimë aq shumë për të kaluarën tone rreth traditave, kulturave të gjithë popullit shqiptar. Me rëndësi është që ne pa kaluar edhe shumë vite të marim pak njohuri nga mitologjia dhe kultet e popullit shqiptar që pikërisht lidhen edhe me folklorin shqiptar që është shumë me rëndësi për të kaluarën tonë por edhe të tashmen.

Ky punim mund të ndikoj në shumë drejtime sepse lidhet me disa fusha me rëndësi për gjuhën shqipe me folklorin, etnolinguistikën, mitologjin etj.

Pikërisht, në këtë punim u dhanë konkluzione të sakta rreth kultit të numrave që janë përdorur dhe kuptojmë që janë edhe sot me rëndësi përdorimi i këtyre numrave tek populli shqiptar, së pari të shpjegoj bashkë me brendin e thelbin e tyre, se cilat janë rrënjët historike e shoqërore të tyre si veçori të popullit që i bartë ato dhe të lidhjes me popujt të tjerë, të shpjegoj strukturat më të lashta të tyre dhe ndryshimet që kanë pësuar nga koha në kohë në përkim me faktor të ndryshëm historik, shoqëror e ekonomik, së dyti të shpjegoj rrethanat që kushtëzojnë ruajtjen e funksionet e këtyre miteve, riteve e besimeve deri në këta shekujt e fundit, të shpjegoj rolin që ato kanë luajtur në jetën e popullit ku më së shumti e gjejmë në kulte të jetës familjare e të bashkësisë fisnore si në kultin e gjarpërit, në besime e rite të trashëguarit e emrave vetjakë, në kultin e të vdekurve, në tiparet e festave në kultin e majave të maleve, në figura mitologjike si kuçedra, dragoi, zanat, barrit, orët etj.

Në popullin tonë elemente të ndryshme të mitologjisë dhe besimeve në disa krahina rruhen më shumë e në të tjerat më pak, këto më tepër rruhen në malësitë shqiptare, në alpet e Shqiprisë veriore në Labëri në disa vise të Kosovës, tek shqiptarët e Maqedonisë etj, disa rite përdoren dhe janë rruajtur njëjtë si në kohët e hershme ndërsa disa janë zhdukur dhe nuk përmenden si rite, besime, mite etj.

Duke njohur në mënyrë shkencore rrënjët shoqërore e historike të miteve, riteve e besimeve fetare në jetën e popullit, hapet një rrugë e gjërë për të kuptuar më mirë psikologjinë e popullit prirjet e tij në zhvillim.

Gjatë gjithë analizës së bërë në këtë punim dalim në përfundim që rite mite dhe besime kemi në të gjithë trevat e popullit shqiptar, ku në veçanti hasim të përdorur numra kulti në përralla, balada, lirika, këngët kreshnike, legjendat, fabulat, anekdotat ku si numra më të spikatur i

kemi numrat e kultit tre, shtatë, nëntë, dymbëdhjetë, dyzet si dhe numra të tjerë që përbëhen nga këto numra.

Nuk mund ta hedhim poshtë përdorimin më të shpeshtë të numrit tre që dallon nga përdorimi i numrave të tjerë të kultit që janë më pak të përmendura.

Një ndër faktet e rëndësishme që nxirret nga kjo analizë e detajuar është se po të njejtat numra kulti janë përdorur si në kohët e të parëve tanë ilirët nëpër mitet e asaj kohe por gjithashtu të njetat numra kulti i gjejmë edhe nëpër përallat, baladat, lirikat e kohëve më të fundit që na bën të nënkuptojmë një lidhje apo rrjedhshmëri ngjarjesh nga ku na bën të kuptojmë se kemi të bëjmë me të njejtin popull.

Gjatë analizës rëndësi të veçantë i kushtuam edhe kuptimit të numrit si dhe klasifikimit të leksemave për secilin numër në veçanti dhe nxorrëm në pah shumë kuptime rreth përdorimit të numrave të lartpërmendura.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Arifi, N. (2004). *Përralla popullore*. Tetovë
- Akademia e Shkencave. (1992). *Kultura popullore 1-2*. Tiranë
- Akademia e Shkencave. (1994). *Kultura popullore 1-2*. Tiranë
- Akademia e Shkencave. (1998). *Kultura popullore 1-2*. Tiranë
- Akademia e Shkencave. (1999). *Kultura popullore 1-2*. Tiranë
- Berisha, N. A.. (2008). *Antologji e kangëve kreshnike shqiptare* .Prishtinë
- Berisha, N. A. (1998) *Qasje poetikës së letërsisë gojore shqipe*. Prishtinë
- Bexheti, V. (2012). *Nga lirika popullore e Tetovës me rrethinë*. Tetovë
- Bexheti, V. (2015). *Jehu dhe tehu i fjalës*. Tetovë
- Barleti, M. (2012). *Rrethimi i Shkodrës*. Tiranë
- Çetta, A. (1990). *Prozë popullore nga Drenica 2*. Prishtinë
- Dara, G. (1955). *Kënga e sprasme e Balës*. Tiranë
- Demiraj, B. (1997). *Sistemi i numërimit të gjuhës shqipe*. Tiranë
- Elsie, R. (1997). *Historia e letërsisë shqiptare*. Tiranë - Pejë
- Fishta, Gj. (2005). *Vepra letrare 5*. Tiranë
- Fetiu, S. (2000). *Balada popullore shqiptare*. Prishtinë
- Frashëri, K. (2008). *Historia e qytetërimit shqiptar*. Tiranë
- Ibrahimi, M. (2003). *Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i pellagonisë*. Shkup
- Ibrahimi, M. (2012). *Tema sociolinguistike dhe etnolinguistike*. Shkup
- Ibrahimi, M. (2015). *Trajtesa leksiko – frazeologjike të shqipes*. Shkup
- Ibrahimi, M. (2016). *Gjuhë dhe kulturë*. Shkup
- Ibrahimi, M. (2017). *Proza gojore shqiptare nga treva e Prilepit dhe Krushevës*. Shkup
- Ibrahimi, M. (2018). *Variante të Baladës “Motra me 9 vëllezër” te shqiptarët e Prilepit dhe Krushevës*. Në revistën “ Zëri i Pelagonisë”, nr 12 (45), 2018 (fq.5-22).
Interlingua:Shkup.
- Ismajli, R. (1991). *Gjuhë dhe etni*. Prishtinë
- Kadare, I. (2004). *Kush e solli Doruntinën*. Tiranë
- Lloshi, Xh. (2005). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*. Tiranë
- Neziri, Z. (2016). *Epika gojore shqiptare*. Shkup
- Osmani – Selimi, E. (2007). *Lirika popullore në trevat e Tetovës dhe të Gostivarit II*. Tetovë
- Osmani – Selimi, E (2017). *Përralla popullore shqiptare*. Tetovë
- Papleka, A. (2005). *Balada shqiptare*. Tiranë

- Sulejmani, F. (1988). *Lindja, martesja dhe mortja në Malsitë e Tetovës*. Prishtinë
- Shuteriqi, Dh. (1987). *Vepra letrare 9*. Tiranë
- Taipi, K. (1998). *Këngë popullore shkodrane*. Tiranë
- Tirta, M. (2004). *Mitologjia ndër shqiptarë*. Tiranë
- Uçi, A. (1982). *Mitologjia Folklori Letërsia*. Tiranë
- Visaret e Kombit.(2005).*Eposi i Kreshnikëve dhe Legjenda*, Tiranë
- Xhaferi, H. (2014). *Çështje letrare*. Shkup
- Xhaferi, H. (2014). *Letërsi gojore shqiptare (dispensë)*, Tetovë
- Zoto, V. (2006). *Eposi i kreshnikëve*. Tiranë

PËRMBLEDHJE

Teza e masterit e këtij lloji nuk është punuar kurrë më parë dhe që kur kultura dhe tradita shqiptare është përhapur gjerësisht, kërkon analiza më të thella dhe unë kam qenë gati ta marrë këtë sfidë.

Në këtë tezë të magjistraturës u përpoqa të theksoj sa më shumë që është e mundur kultin e numrave të përdorur nga kombi ynë, të cilët ende sot disa prej këtyre numrave po përdoren në traditat dhe ritualet tona.

Ngjajshëm me këto numra të kultit që përdoren nga kombet tona, gjithashtu përdoren edhe në vende të tjera si Kroacia, Bosnja dhe Serbia.

Besimet popullore rreth numrave tre, shtatë dhe nëntë zakonisht i lidhin këto numra me fuqitë magjike dhe besimet paragjykuese.

Në këtë tezë të magjistraturës përmes punës hulumtuese dhe analizave, po përpiqem t'u përgjigjem sa më shumë pyetjeve sa është e mundur, sa i përket kuptimit të këtyre numrave, besimeve të kombit shqiptar në numra të caktuar, ku arrijmë të shohim këto besime etj.

Gjatë punës në vazhdim gjithashtu bëm për çdo numër analizë rreth kuptimit të numrit në situata të caktuara të potencialit leksiko semantik, si një ndër numrat më të përdorur dhe që ka më shumë kuptime të lidhura me besimet është numri tre që ka një peshë më të madhe.

Rasti tjetër më i shpeshtë nga tregime shqiptare popullore është emrtimi për numrin tre, tridhjetë, treqind, shtatë, nëntë, dymbëdhjetë, dyzet, ku bëm analizë rreth klasifikimit dhe rishikimit të të gjitha leksemave me të cilat këta numra qëndrojnë.

Duke arritur në përfundim nga kjo temë u detyruam të krijojmë edhe një fjalor sepse përdorimi i fjalëve në terme dialektore ishte i tepërt, sepse analizuam këngë që këndohen në një krahinë në një zonë të caktuar, balada, përralla, anekdota etj. dhe ne e dimë që gjuha shqipe ka dy dialekte por edhe shumë nën dialekte tjera që fliten nëpër krahina të caktuara, dhe e domosdoshme është shpjegimi i disa termeve.

Kjo tezë e masterit dhe hulumtimet dhe analizat e saj, mund të jenë pjesë e një libri ose një dorëshkrim, i cili nuk do t'i kushtohet vetëm studentëve dhe intelektualëve, por edhe njerëzve të tjerë që janë në kontakt me ndryshimet. Dhe nga këtu kemi ardhur në përfundimin

se kjo tezë e përfunduar e masterit do të shërbejë si një material informativ në lidhje me kulturën, folklorin, traditat dhe ritualet shqiptare.

РЕЗИМЕ

Никогаш порано на магистерски теза од ваков вид ваква тема не е работена или истражена и бидејќи албанската култура и традиција се широко распространети, таа бара повеќе длабинска анализа и јас сум подготвена да го прифатам овој предизвик.

Во оваа магистерска теза се обидов да го потенцирам колку што е можно култот на броевите што ги користи нашата нација, што и денес денес дел од овие броеви се наоѓаат во нашите традиции и ритуали.

Слично на овие култни броеви што ги користат нашите народи, тие се користат и во други земји, како што се Хрватска, Босна и Србија.

Популарните верувања за броевите три, седум и деветти обично ги поврзуваат овие бројки со магични сили и суеверни верувања.

Во оваа магистерска теза преку истражувачка работа и анализа, се трудам да одговорам што е можно повеќе прашања за значењето на овие броеви, верувањата на албанската нација во одредени бројки, каде што доаѓаме да ги видиме овие верувања итн.

За време на тековната работа направивме длабинска анализа на разбирање за секој број на начинот на кој бројот се третира или се користи во одредени ситуации на лексичко семантичкото значење, и како еден од најчесто користените броеви и кој има повеќе значења поврзани со верувањата е бројот три.

Најчестиот случај на популарните албански приказни е бројот три, триесет, триста, седум, девет, дванаесет, четириесет, каде што ја анализиравме класификацијата и прегледот на сите лексеми со кои се наоѓаат овие бројки.

Завршувајќи ја оваа тема, бевме принудени да создадеме речник, бидејќи употребата на зборови во дијалектички термини беше излишно, бидејќи ги анализиравме песните испеани во провинција во дадена област, балади, бајки, анегдоти и така натаму, а знаеме дека албанскиот јазикот има две дијалекти, но и многу други под дијалекти што се зборуваат во одредени провинции, и неопходно е да се објаснат некои термини.

Оваа магистерска теза и нејзиното истражување и анализа може да бидат дел од некоја книга или скрипта која не само што ќе биде посветена на студенти и интелектуалци туку и на други луѓе кои се во контакт со промените. Освен тоа, од тука дојдовме до

заклучок дека оваа завршена магистерска теза ќе служи како информативен материјал во албанската култура, фолклор, традиција и ритуали.

SUMMARY

Never before on a master thesis of this kind has been worked or investigated on and since the Albanian culture and tradition is widespread, it requires more in-depth analysis and I have been ready to take up this challenge.

In this master thesis I tried to emphasize as much as possible the cult of numbers used by our nation, which still today some of these numbers are being seen in our traditions and rituals.

Similar to these cult numbers used by our nations, they are also used in other countries like Croatia, Bosnia and Serbia.

Popular beliefs about numbers three, seven, and ninth usually tie these numbers to magical powers and superstitious beliefs.

In this master thesis through research work and analysis, I try to answer as many questions as possible about the meaning of these numbers, the beliefs of the Albanian nation in certain numbers, where we come to see these beliefs, etc. .

During the on-going work we made an in depth analysis of understanding for each number of how the number is treated or used in certain situations of lexicon semantic meaning, and as one of the most used numbers and having more belief-related meanings is the number three.

The most common case of popular Albanian stories is the number three, thirty, three hundred, seven, nine, twelve, forty, where we analyzed the classification and review of all the lexemes with which these numbers lie.

Concluding this subject we were forced to create a vocabulary because the use of words in dialectal terms was superfluous, because we analyzed songs sung in a province in a given area, ballads, fairy tales, anecdotes, and so on, and we know that Albanian language has two dialects but also many other under dialects spoken in certain provinces, and it is necessary to explain some terms.

This master thesis and its research and analysis can be part of a book or script that will not only be devoted to students and intellectuals but also to other people who are in touch with the changes. In addition, from here we have come to the conclusion that this completed master thesis will serve as an information material about Albanian culture, folklore, traditions and rituals.

Fjalor

A

Aga - *m.* pronar tokash më i vogël se beu

Arousha - *f.* femra e ariut

Askier - *m.* i riu që kryen shërbimin ushtarak

B

Bajrakë- *m.* flamur. bajrak i kuq.

Bejleg- *m.* dyluftim.

Bereqeti - *m.* drithë; të lashtat e mbjella dhe prodhimi i tyre.

Birë - *f.* vrimë.

Brina - *f.* eshtë e trupit të njeriut dhe të kafshëve të mëdha, e gjatë, e ngushtë dhe e kthyer si hark.

C

Calinat- *f. Shum.* armë brezi me grykë të gjerë e me çark

Car - *m.* titull i dikurshëm i perandorit ose i mbretit në disa vende sllave

Caucës -*f.* vajzë

Caull -*m.* fëmijë

Ç

Çak - *onomat.* përdoret si imitim për të shënuar tingullin e dobët, që del kur goditet diçka e fortë.

Çashtej -*ndajf.* tani

Çatallue - *mb.* që është rritur i ndarë me dysh qysh nga rrënja ose nga tringu.

Çeta -*f.* grup i vogël njerëzish të armatosur me një kryetar a komandant në krye, që kryejnë veprime të përbashkëta.

Çezmja- *f.* gyp a lug nga ku rrjedh ujë i pijshëm, që vjen prej ujësjellësit ose prej një burimi të mbuluar;

Çiçja-*f.*e gjora

Çika - *f.* vajzë

Çkriu - *kallx.* shkriju

Çpiket - *f.* shpikje

Çudë - *f. krahin.* çudi.

D

Dajti - *krah.* ndau, ndarje

Dakika - *f.* minuta

Dert - *m. bised.* brengë, shqetësim

Dervejsh - *m.* murg i sektit bektashian, që jeton e kryen shërbime fetare në një teqe (në vendet ku vepron feja myslimane

Dënise - *ndajf.* diçka

Diftue - *m.* treguar

Dilberin -*turq.* djal i mirë

Dost -*krah.* mik

Drue-*krah.* ndrojë, hezitim

Duj-*krah.* thes

Duket-*krah.* shifet

Dushkë - *m.* dru i lartë pyjor me kurorë të dendur, me gjethe të shumta e të dhëmbëzuara, që lidh lende dhe që e ka lëndën mjaft të fortë e të rëndë

Dyfek - *m.* pushk/ë

Dymdhet - *n.* dymbëdhjetë

E

Elvida - *turq.* mirupafshim

F

Flaç -*f.* flas

Fugjin - *f.* hudhin

Fukara - *mb.* i varfër

G

Gajlen- *f. bised.* kokëçarje, hall; shqetësim, merak.

Gazdaric - *f.* pronare

GJ

Gja - *krah.* bagëti

Gjepa- *m.* xhep

Gjëftej - i lodhur

H

Hajvonat - *krah.* bagëti

Hallate - *m.* vegla

Hëzri -*islam.* xhind

Honmi -*turq.* grua e bukur

I

Idajre - *turq.* të mjaftohesh

Izet e shtat - *n.* njëzet e shtatë

K

Kaç- *m.* kafshon

Kaçakve - *krah.* grabitës

Kapaklisë - *turq.* të përmbyllësh

Kapidana - *m.* kryetar i një ushtrie

Karadak - *turq.* mal i zi

Kasapit - *m.* ai që ther bagëti

Katouni - *m.* fshat

Këllicë - *ndajf.* për së gjati, duke e mbështetur në faqen më të ngushtë.

Kërset - *krah.* krismë

Këtejne - *përem.* këtyre

Kinse - *I. pj.* gjoja

Kja -*f.* qarje

Kriçet - *krah.* vithet

Kulaç- *m.* buk e ngjeshur

Kumbara - *I f.* kuti e vogël prej teneqeje

Kundruell -*I. ndajf.* përballë, kundrejt.

Kurnise - *pakuf.* asgjë

Kurtalis - *turq.* të shpëtosh

Kusi - *f.* enë e rrumbullakët dhe e thellë

L

Lajle - *f. kryes.* lule në trajta të ndryshme të vizatuara a të pikturuara mbi diçka si zbukurim

Lam - *f.* oborr

Lija - *krah.* sëmundje ngjitëse

Llreka - *f.* foshnje

Liv - *mb.* që është lyer me bojë a me një lëndë tjetër të lëngshme ose të butë.

Lngatë - *f.* sëmundje e rëndë

Lugadh - *krah.* lugat, krijesë e frikshme

Lypanikut - *mb. përçm.* që lyp derë më derë

LL

Llaf - *m.* fjalë

Llost - *krah.* shkop

M

M'çe. - *mb.* fshehur

Marifet - *m.* shkathtësi

Mart - *sllav.* mars

Martina - *f.* lloj pushke e gjatë

Mejdanxhi - *turq.* njeri i shëtitor

Meraba - *turq.* përshëndetje

Mësyva - *dialek.* u nisa

Mëzatit - *m.* viç mashkull nga një deri në tre vjeç

N

N'tetuer... - *m.* në tetor

N'xhalli - *krah.* ringjallje

Nam - *m.* emri që i del dikujt ose mendimi që është krijuar për dikë a për diçka për të mirë ose për të keq.

Nandë - *n.* nëntë

Ndaj - *kal.* shkëput

Ndërzen - *kal.* bashkoj femrën e një kafshe shtëpiake me mashkullin

Ngran - *f.* ngrënë

Nizamë - *m. hist.* ushtar i shërbimit të detyrueshëm në kohën e Turqisë

O

Ogiçin - *m.* dash i madh me këmborë

Ograk - *krah.* të sëmuresh

Ostallar - *m.* mjeshtër

P

Pajsë - *krah.* pyes

Pejka - *krah.* rrash

Penxheret - dritaret

Pisket - *krah.* bërtet

Pjuma - *krah.* plumb

Pletajtun - *sllav.* të gërshetosh

Pllom - *f. Krah.* pëllëmbë

Pqaka - *krah.* plakë

Prajt - *krah.* prit

Pusto - *krah.* mallkim

Q

Qefilë - *m. vjet.* dorëzanë

Qiarxhi - *m.* ai që banon me qira në shtëpinë e një tjetri, qiramarrës.

R

Rize - *f.* peshqir me push për të fshirë fytyrën.

Rohet - *krah.* ruhet

Rrunx - *krah.* rruaz

Rrxue –mb. rrëzuar

S

Sahati – turq. ora

Selam– turq. të fala

Sëllde – turq. vetëm

Sinet – krah. syneti

Sypri –krah. përmbi

SH

Shehit – turq. shenjtor

Shëndoshen – krah. shërohen

Shëndreut – krah. shkëlqeu

Shishane - f. vjet. një lloj pushke e vjetër me strall,

Shkrola - shkrolës m. vjet. vegël druri si vulë,

Shkusët – krah.njerëzit që shkojnë për të kërkuar dorën e nuses

Shqie –krah.sllav

Shtaj – krah. fut

Shtatçin – n. shtatëqind

Shtizën - f. hist. heshtë

Shul- m. dru i drejtë e i gjatë,

T

Tallaganet - m. gunë e leshtë burrash

Terma – krah. lartë

Tfillue – krah. filluar

Tfishkllova – krah. fishkëllimë

Topuzi – m. shkop i trashë prej druri a prej hekuri

Topxia – krah.ai i cili gjuan me top

Touta – krah. frikë

Tredhet – n. tridhjetë

Trejm – m. trim

TH

Thaush – krah. thuash

U

Ullës – krah. rruga

Upe – krah. prapë

Uzdaja – krah. shpresë

V

Vakti – turq.kohë

Vojti – krah. shkoi

Vringllue– kal. e ngrë dhe e tund a e vërtit shpatën

XH

Xhi – krah. çfarë

Xhilihonen – krah.e bukur

Xhinde– f.vajzë a grua shumë e bukur

ZH

Zhurite – kal. digje